

| <b>RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT</b>        |  |
|--|--|
| <b>EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS</b>      | Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin 55/2020 “Për shërbimet e pagesave”.   |
| <b>MINISTRIA UDHËHEQËSE</b>                    | Ministria e Financave  |
| <b>FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT</b> | Finale   |
| <b>BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS</b>        | I brendshëm/transpozim i BE-së/ndërkombëtar  |
| <b>DIREKTIVË E BE-së</b>                       | <p>➤ Direktiva (BE) 2015/2366 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 25 nëntor 2015 “Për shërbimet e pagesave në tregun e brendshëm, dhe që ndryshon Direktivat 2002/65/KE, 2009/110/KE dhe 2013/36/BE dhe Rregulloren (BE) nr. 1093/2010 dhe që shfuqizon Direktivën 2007/64/KE”, e konsoliduar, e ndryshuar nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Direktiva 2022/2556/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 14 Dhjetor 2022, që ndryshon Direktivat 2009/65/KE, 2009/138/KE, 2011/61/BE, 2013/36/BE, 2014/59/BE, 2014/65/BE, (BE) 2015/2366 dhe (BE) 2016/2341, në lidhje me qëndrueshmërinë operacionale digjitale për sektorin financiar;</li> <li>- Rregullorja 2024/886/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 13 Mars 2024 që ndryshon Rregulloret (BE) Nr. 260/2012 dhe (BE) 2021/1230 dhe Direktivat 98/26/KE dhe (BE) 2015/2366, në lidhje me transfertat e menjëhershme të kreditit në euro.</li> </ul> <p>➤ Direktiva 2009/110/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 16 Shtator 2009 ”Mbi krijimin, ushtrimin dhe mbikëqyrjen e kujdesshme të veprimtarisë të institucioneve të parasë elektronike që ndryshon Direktivat 2005/60/KE dhe 2006/48/KE dhe që shfuqizon Direktivën 2000/46/EC”, e ndryshuar nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Direktiva (BE) 2015/2366 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 25 nëntor 2015 “Për shërbimet e pagesave në tregun e brendshëm, dhe që ndryshon Direktivat 2002/65/KE, 2009/110/KE dhe</li> </ul> |

|  |  |
|--|--|
|  | 2013/36/BE dhe Rregulloren (BE) nr. 1093/2010 dhe që shfuqizon Direktivën 2007/64/KE”.         |
| <b>PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA</b>  | Plani i masave për plotësimin e Piketave Mbyllëse të Kapitullit 4 “Lëvizja e lirë e kapitalit” |
| <b>DATA E KONSULTIMIT PUBLIK</b>   | 04/05/2026 – 01/06/2026  |
| <b>DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT</b>   | 24/06/2026   |
| <b>A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT</b> | Po/Jo<br>02/06/2026  |
| <b>NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT</b>  | 2026 – MF - 5  |
| <b>TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TËPERSONIT TË KONTAKTIT)</b>             | Click here to enter text.  |

## **PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

(Maksimumi 2 faqe)

### **PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT**

*Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja qeverisë?*

Problemi në shqyrtim lidhet me nevojën për përmirësim dhe plotësimin e kuadrit ligjor në fushën e pagesave dhe emetimit të parasë elektronike. Qëllimi i këtyre ndryshimeve ligjore është përmirësimi i funksionimit të tregut të pagesave duke e përshtatur edhe me kërkesat më të fundit të aplikueshme në nivel evropian, rritja e konkurrencës dhe ulja e kostove për shërbimet e pagesave, rritja e sigurisë në ofrimin e këtyre shërbimeve, forcimi i kërkesave për mbrojtjen e konsumatorëve, rregullimi në nivel ligjor i kërkesave për paranë elektronike dhe emetimin e saj, si dhe rregullimi i veprimtarisë ndërkufitare të subjekteve pas anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Këto ndryshime synojnë gjithashtu përafrimin e mëtejshëm me *acquis* të Bashkimit Evropian, në veçanti me Direktivën (EU) 2015/2366 (PSD2) dhe ndryshimet pasuese të saj, si dhe me Direktivën (KE) 2009/110 (EMD2), në përmbushje të angazhimeve që rrjedhin nga procesi i integritimit evropian.

Ndryshimet synojnë:

- Rritjen e transparencës dhe sigurisë në pagesa;
- Uljen e kostove për përdoruesit e shërbimeve të pagesave;
- Përmirësimin e kërkesave për mbrojtjen e përdoruesve të shërbimeve të pagesave;
- Rregullimin me ligj të kërkesave për paranë elektronike dhe emetuesit e saj;
- Ushtrimin e të drejtës së vendosjes dhe lirisë për të ofruar shërbime midis Shqipërisë dhe shteteve të tjera anëtare, pas anëtarësimit të Shqipërisë në BE;
- Përafrimin me standardet e zbatueshme në nivel evropian.

Nisma e ndërmarrë për rishikimin e ligjit 50/2020 “Për shërbimet e pagesave”, përbën një hap të rëndësishëm në kuadër të reformave që po ndërmerren nga Banka e Shqipërisë, për rishikimin dhe plotësimin e kërkesave të zbatueshme ligjore në fushën e shërbimeve të pagesave dhe parasë elektronike dhe përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit shqiptar me *acquis* të Bashkimit Evropian, në funksion të përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritit evropian të vendit, por edhe të anëtarësimit të Shqipërisë dhe ofruesve të shërbimeve të pagesave të licencuar në Shqipëri, në zonën SEPA. Nevoja për përafrimin e plotë të legjislacionit të brendshëm me direktivat e BE-së është një ndër angazhimet kryesore të Bankës së Shqipërisë si institucion lider i Kapitullit 4 “Lëvizja e lirë e kapitalit”. Këto ndryshime shërbejnë edhe në funksion të nismës kombëtare “*Cashless Albania 2030*”, pasi rritja e përdorimit të pagesave elektronike dhe si rrjedhojë reduktimi i përdorimit të *cash*-it, vlerësohet se kanë një kontribut të rëndësishëm në objektivin e qeverisë për uljen e nivelit të përdorimit të *cash*-it në ekonomi dhe zhvillimin ekonomik të vendit.

Në praktikë, kuadri aktual ligjor dhe rregullativ në fushën e shërbimeve të pagesave dhe emetimit të parasë elektronike, ka krijuar një bazë të rëndësishme për tregun e pagesave në Shqipëri, por përafrimi i plotë i kërkesave të Direktivave të BE të cituara më lart, përfshirë edhe ndryshimet e fundit në vetë Direktivën PSD2, lindin nevojën për përditësimin dhe përshtatjen e mëtejshme të këtij kuadri. Pa një ndërhyrje të tillë, ekziston rreziku që kuadri ligjor kombëtar të mos jetë plotësisht i harmonizuar me standardet dhe kërkesat më të fundit evropiane, duke krijuar mangësi në cilësinë e shërbimeve të pagesave që u ofrohen klientëve (përfshirë edhe konsumatorët dhe mikrondërmarrjet) të ofruesve të shërbimeve të pagesave. Nga ana tjetër, rregullimi me ligj i kërkesave për paranë elektronike dhe emetuesit e saj (ku një pjesë e këtyre kërkesave janë tashmë të parashikuara në kuadrin nënligjor), synon forcimin e kërkesave dhe krijimin e një tregu më të konsoliduar. Gjithashtu, krijimi i një kuadri ligjor që do të rregullojë ushtrimin e veprimtarisë ndërkufitare të institucioneve të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike, si dhe unifikimin e kërkesave për kryerjen e shërbimeve të pagesave apo emetimin e parasë elektronike ndërmjet Shqipërisë dhe shteteve të tjera anëtare, pas anëtarësimit të Shqipërisë në BE, është një hap i nevojshëm paraprak për plotësimin e kornizës ligjore në këtë aspekt, si dhe për përgatitjen e tregut dhe autoritetit mbikëqyrës për zbatimin e rregullave që do të bëhen të aplikueshme pas anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Në nivel të Bashkimit Evropian, vetë Direktiva 2015/2366/BE (PSD2) ka pësuar disa ndryshime, për të përmirësuar kërkesat e autoriteteve mbikëqyrëse, por edhe për të rritur sigurinë dhe shpejtësinë e ofrimit të shërbimeve të pagesave. Kuadri aktual ligjor në Shqipëri nuk i përfshin këto kërkesa të reja apo të rishikuara, të cilat janë miratuar nga Komisioni Evropian, pas miratimit të ligjit 55/2020 “Për shërbimet e pagesave”, duke e bërë të nevojshëm përditësimin e ligjit për të reflektuar zhvillimet e reja në fushën e shërbimeve të pagesave.

Një tjetër çështje e rëndësishme lidhet me rregullimin nëpërmjet një akti ligjor, të kuadrit të licencimit, ushtrimit të veprimtarisë dhe mbikëqyrjes së institucioneve të parasë elektronike. Direktiva e BE-së që rregullon institucionet e parasë elektronike dhe emetimin e parasë elektronike, është përafuar veçanërisht nëpërmjet akteve nënligjore të Bankës së Shqipërisë. Megjithatë, për të siguruar qartësi, qëndrueshmëri dhe siguri më të lartë juridike, është e nevojshme që kërkesat kryesore për institucionet e parasë elektronike të integrohen në ligjin nr. 55/2020, ndërsa aspektet teknike dhe operacionale të vijnë të rregullohen përmes akteve nënligjore.

Gjithashtu, përafrimi ligjor me legjislacionin e BE në fushën e shërbimeve të pagesave synon plotësimin e një prej angazhimeve institucionale në kuadër të integritetit evropian, të marra nga Banka e Shqipërisë sipas piketave mbyllëse të Kapitullit 4. Për këtë qëllim, projektligji përfshin edhe dispozita që do të bëhen të zbatueshme pas anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, duke krijuar bazën për veprimtarinë ndërkufitare të institucioneve të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike, si dhe për bashkëpunimin me autoritetet homologe të shteteve anëtare.

Në këtë mënyrë, rishikimi i ligjit nr. 55/2020 synon jo vetëm harmonizimin me standardet evropiane, por edhe modernizimin e kuadrit të shërbimeve të pagesave në Shqipëri, në funksion të krijimit të një tregu më të besueshëm, më të sigurt, më transparent, më konkurrues dhe më të përafuar me praktikatat më të mira ndërkombëtare.

## **OBJEKTIVAT**

*Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?*

Përmes projektligjit të propozuar, synohet arritja e objektivave të mëposhtme:

1. Harmonizimi i plotë i legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Evropian në fushën e shërbimeve të pagesave dhe parasë elektronike, në kuadër të procesit të integritetit evropian;
2. Plotësimi i kuadrit ligjor ekzistues në përputhje me Direktivën (BE) 2015/2366 (PSD2) dhe Direktivën (KE) 2009/110 (EMD2), duke përfshirë edhe ndryshimet dhe zhvillimet më të fundit të këtyre direktivave, veçanërisht për PSD2 në lidhje me qëndrueshmërinë operacionale digjitale dhe pagesat e menjëhershme (*instant payments*);

3. Rritja e sigurisë juridike dhe qartësisë rregullatore për institucionet e parasë elektronike dhe emetimin e parasë elektronike.
4. Garantimi i njohjes së ndërsjellë të licencave (*passporting*), që mundëson ofrimin e shërbimeve ndërkufitare pas anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.
5. Rregullimi i qartë i marrëdhënieve, bashkëpunimit dhe ndarjes së përgjegjësisive ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe autoriteteve homologe mbikëqyrëse të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, pas anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian;
6. Përcaktimi i rregullave të detajuara për aktivitetin ndërkufitar, përfshirë hapjen e degëve nga institucionet shqiptare në vende të treta dhe nga institucionet e huaja në Shqipëri;
7. Rritja e transparencës në tregun e shërbimeve të pagesave dhe përmirësimi i informimit të përdoruesve mbi kushtet, tarifat dhe të drejtat e tyre;
8. Përcaktimi i kërkesave për tarifat e shkëmbimit në transaksionet me kartë, në përputhje me Rregulloren (BE) 2015/751, me qëllim uljen e kostove të këtyre transaksioneve.
9. Përcaktimi i kushteve për pjesëmarrjen e institucioneve të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike në sistemet e pagesave me finalitet shlyerjeje.
10. Garantimi i stabilitetit dhe integritetit të sistemeve të pagesave përmes rregullave të pjesëmarrjes së institucioneve të pagesave dhe të parasë elektronike.
11. Qartësimi dhe forcimi i të drejtave dhe detyrimeve të përdoruesve dhe ofruesve të shërbimeve të pagesave, duke reflektuar praktikatat më të mira evropiane.

Në tërësi, realizimi i këtyre objektivave pritet të kontribuojë në krijimin e një sistemi të përafuar plotësisht me kuadrin evropian të shërbimeve të pagesave, duke mbështetur kështu edhe qasjen e qeverisë shqiptare për të ulur pagesat me *cash* dhe përdorimin e pagesave elektronike, të kanalizuar nëpërmjet ofruesve të shërbimeve të pagesave të licencuar nga Banka e Shqipërisë dhe, me anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian edhe nëpërmjet ofruesve të shteteve të tjera anëtare që mund të përdorin të drejtën e ofrimit direkt të shërbimeve në Shqipëri, pa qenë nevoja e licencimit nga Banka e Shqipërisë. Ushtrimi i kësaj të drejte do të ndikojë edhe te ofruesit e shërbimeve të pagesave të licencuar nga Banka e Shqipërisë, të cilët kur Shqipëria të anëtarësohet në BE, do të kenë të drejtën e ofrimit të shërbimeve të tyre, edhe në vende të tjera të Bashkimit Evropian.

Zbatimi i projektligjit pritet të sjellë efekte pozitive në përmirësimin e funksionimit të tregut të pagesave, të nxitë inovacionin dhe hyrjen e aktorëve të rinj në treg, duke rritur konkurrencën ndërmjet ofruesve të shërbimeve. Njëkohësisht, ai synon të forcojë mbrojtjen e konsumatorëve dhe besimin e publikut në sistemin financiar, nëpërmjet rregullave më të qarta dhe standardeve më të larta të transparencës dhe sigurisë. Në një perspektivë më të gjerë, projektligji krijon kushtet e nevojshme për integrimin gradual të tregut shqiptar të pagesave me tregun evropian, duke kontribuar në rritjen e besimit të investitorëve dhe zhvillimin e mëtejshëm të sektorit financiar në vend.

## **OPSIONET E POLITIKAVE**

*Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të disavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.*

Opsionet e mëposhtme janë vlerësuar në funksion të arritjes së objektivave të politikave:

**Opsioni 0 (status quo)** - nënkupton moskryerjen e ndryshimeve rregullatore dhe jorregullatore, por vijimin me kuadrin ligjor aktual, përkatësisht ligjin 55/2020 “Për shërbimet e pagesave”, së bashku me aktet nënligjore përkatëse në zbatim të tij.

Ky opsion parashikon vijimin e zbatimit të ligjit 55/2020, pa ndërhyrje të mëtejshme, por vlerësohet se nuk është i përshtatshëm për t’u zbatuar, për arsye se ligji aktual “Për shërbimet e pagesave” nuk parashikon një rregullim të plotë dhe në harmonizim të plotë me legjislacionin e BE-së në këtë fushë, duke pasur mangësi në lidhje me parashikimin e plotë të dispozitave të Direktivës PSD2 dhe Direktivës së Parasë Elektronike (EMD2), veçanërisht në lidhje me marrëdhëniet ndërmjet shteteve anëtare, për bashkëpunimin ndërkufitar, njohjen reciproke të licencave, si edhe lidhur me detyrimet për shkëmbimin e informacionit ndërmjet autoriteteve përgjegjëse dhe rregullimin e plotë të institucioneve të parasë elektronike. Këto dispozita synojnë të sigurojnë zbatimin uniform të legjislacionit dhe funksionimin e një tregu të integruar të shërbimeve të pagesave në Bashkimin Evropian. Për më tepër edhe pse ky opsion nuk paraqet kosto të shtuar në burime, përsëri nuk është i përshtatshëm, pasi nuk mund të arrihet përputhshmëria e plotë me direktivën PSD2 dhe direktivën EMD2, si pjesë e piketave mbyllëse të Kapitullit 4 “Lëvizja e lirë e kapitalit”.

**Opsioni 1 (jorregullator)** - nënkupton marrjen e masave jorregullatore si kryerja e fushatave ndërgjegjësuere dhe forcimi i praktikave mbikëqyrëse. Ky opsion mbështetet në rritjen e ndërgjegjësimit përmes fushatave informuese, trajnimeve dhe aktiviteteve edukative të institucioneve të pagesave dhe të parasë elektronike dhe klientëve të tyre, pa ndryshime në kuadrin ligjor. Megjithëse kontribuon në përmirësimin e njohurive të subjekteve dhe përdoruesve të shërbimeve të pagesave dhe mund të ketë kosto më të ulëta se opsione të tjera, ai nuk siguron zgjidhje afatgjatë për mangësitë e identifikuara në kuadrin ligjor, nuk mundëson plotësimin e angazhimeve në kuadër të integritimit evropian, si dhe nuk mundëson arritjen e objektivave për unifikimin e kërkesave në fushën e pagesave dhe parasë elektronike me ato të tregut evropian.

**Opsioni 2 (rregullator) – opsioni i preferuar** – nënkupton ndryshimin e ligjit ekzistues, konkretisht ligjit nr.55/2020 “Për shërbimet e pagesave”. Ky opsion ofron fleksibilitet dhe ndërhyrje relativisht të shpejtë, dhe me më pak kosto, krahasuar me miratimin e një ligji të ri. Duke qenë se ligji në fuqi “Për shërbimet e pagesave” i miratuar në vitin 2020, ka përafshuar në masë të konsiderueshme kërkesat e Direktivës PSD2, vlerësohet më e arsyeshme që kuadri ekzistues të plotësohet me dispozitat që nuk kanë qenë relevante në momentin e miratimit të tij ose që janë shtuar më pas në legjislacionin e Bashkimit Evropian. Ndryshimi i ligjit ekzistues mundëson përafrimin e plotë të Direktivës PSD2 (dhe ndryshimeve pasuese të saj nëpërmjet Direktivës 2022/2556/BE dhe Rregullores

2024/886/BE) dhe të Direktivës EMD2, brenda një afati kohor të realizueshëm dhe të përshtatshëm për plotësimin e piketave mbyllëse të Kapitullit 4, duke shmangur çdo vonesë që do të dëmtonte procesin e integritit. Duke ruajtur strukturën bazë të ligjit nr. 55/2020, opsioni 2 siguron vazhdimësi të plotë për subjektet e licencuara, duke eliminuar pasigurinë juridike dhe kostot e përshtatjes që do të lindnin nga zëvendësimi i plotë i ligjit. Opsioni 2 mundëson bashkimin në të njëjtin akt ligjor të kërkesave të zbatueshme për institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike, sipas modelit të lejuar shprehimisht nga Direktiva EMD2 dhe të ndjekur nga shumica e shteteve anëtare të BE-së. Kjo siguron koherencë normative dhe unifikim të kuadrit mbikëqyrës pa nevojën e miratimit të një ligji të ri të dedikuar. Por nga ana tjetër, integrimi i kërkesave të reja të PSD2 dhe EMD2 në strukturën e ligjit ekzistues kërkon kujdes të veçantë teknik ligjor për të shmangur kontradikta ose mbivendosje ndërmjet dispozitave të vjetra dhe atyre të reja.

Opsioni 2 vlerësohet si opsioni më i përshtatshëm për t'u zbatuar, për arsye se nëpërmjet nismës së propozuar nuk do të kryhen ndryshime që prekin të gjithë apo pjesën më të madhe të dispozitave të ligjit në tërësi, por do të mundësohet kryerja e disa saktësimeve dhe shtesave në dispozitat aktuale të këtij ligji. Për pasojë duke qenë se ndryshimet e propozuara nuk do të prekin gjithë ligjin në tërësi, opsioni 2 rezulton si opsion më i përshtatshëm.

**Opsioni 3 (rregullator)** – Miratimi i një ligji të ri në fushën e shërbimeve të pagesave. Ky opsion do të mundësonte riorganizimin e plotë të kuadrit ligjor, por nuk vlerësohet si zgjidhja më e përshtatshme, për arsye se ndryshimet që synohen të ndërmerren kanë për qëllim rregullimin dhe plotësimin e ligjit aktualisht në fuqi nr. 55/2020, duke rregulluar ato pjesë të ligjit të cilat lidhen me marrëdhëniet ndërkufitare dhe vendosjen e rregullave të detajuara për aktivitetin ndërkufitar, të cilat nuk ndikojnë në thelbin dhe strukturën e ligjit ekzistues. Për më tepër hartimi i një ligji të ri paraqet kosto më të madhe në drejtim të burimeve materiale dhe njerëzore krahasuar me opsionet e tjera.

## **ANALIZA E NDIKIMEVE**

*Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.*

Zbatimi i opsionit të preferuar, që konsiston në ndryshimin dhe përditësimin e ligjit 55/2020 “Për shërbimet e pagesave”, pritet të ketë një sërë ndikimesh në nivel institucional, profesional dhe ekonomik. Këto ndikime lidhen kryesisht me përmirësimin e kuadrit të shërbimeve të pagesave dhe emetimit të parasë elektronike, forcimin e sigurisë dhe transparencës, rritjen e konkurrencës dhe harmonizimin e mëtejshëm të legjislacionit shqiptar me standardet dhe praktikatat e Bashkimit Evropian.

Opsioni i preferuar për ndryshimin e ligjit ekzistues pritet të ketë disa efekte, ku sektorët apo grupet kryesore që preken nga këto ndryshime ligjore janë:

- Ofruesit e shërbimeve të pagesave/emetuesit e parasë elektronike;

- Klientët/konsumatorët e ofruesve të shërbimeve të pagesave/emetuesve të parasë elektronike;
- Qeveria/ sektori publik.

Unifikimi i kërkesave për institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike me standardet e tregut evropian, pritet të ketë një efekt pozitiv në rritjen e konkurrencës midis subjekteve dhe krijimin e mundësive për zgjerimin e veprimtarisë së tyre edhe në shtete të tjera të BE-së, pas anëtarësimit në BE. Gjithashtu subjektet duhet të përshtatin sistemet dhe mënyrën e funksionimit sipas kërkesave të reja dhe të rishikuara sipas këtyre ndryshimeve ligjore. Zbatimi i ligjit “Për shërbimet e pagesave” ka ndikuar në përsheptimin e digjitalizimit të pagesave, duke reduktuar varësinë nga mjetet tradicionale me efikasitet të ulët dhe duke nxitur përdorimin e instrumenteve digjitale të sigurta. Ky ndikim u bë edhe më i dukshëm gjatë pandemisë COVID-19, kur u rrit ndjeshëm përdorimi i pagesave elektronike.

Nga pikëpamja e klientëve të ofruesve të shërbimeve të pagesave dhe emetuesve të parasë elektronike, ndryshimet ligjore pritet të kenë një ndikim pozitiv në përmirësimin e tregut të pagesave, uljen e kostove për ofrimin e shërbimeve si dhe forcimin e elementëve të sigurisë në kryerjen e pagesave, ofrimin e shërbimeve më transparente, duke forcuar njëkohësisht mbrojtjen e konsumatorëve dhe besimin në instrumentet elektronike të pagesave.

Për sa i përket efektit në sektorin publik dhe plotësimin të objektivave të qeverisë, këto ndryshime ligjore pritet të kenë ndikim në disa aspekte. Në kuadër të nismës kombëtare “*Cashless Albania 2030*”, rritja e përdorimit të pagesave elektronike pritet të ketë një kontribut të rëndësishëm në arritjen e objektivit për uljen e nivelit të përdorimit të *cash*-it në ekonomi. Nga ana tjetër, përputhshmëria me direktivat përkatëse të BE-së dhe me standardet evropiane, e kërkesave për shërbimet e pagesave dhe emetimin e parasë elektronike, do të ndihmojnë në përmbushjen e angazhimeve të ndërmarra nga qeveria shqiptare, për të lehtësuar integrimin në tregun evropian. Ndryshimet ligjore do të sjellin edhe sfida të reja rregullatore dhe operacionale, të lidhura me mbikëqyrjen e subjekteve të reja (veçanërisht pas anëtarësimit në BE, kur do të zbatohet edhe “*passporting*”), menaxhimin e rreziqeve teknologjike dhe garantimin e një standardi të barabartë ndërmjet bankave dhe institucioneve jo-bankare.

Në përfundim, përafrimi i plotë i kërkesave të PSD2 dhe EMD2 në kuadrin ligjor shqiptar, pritet të kontribuojë në modernizimin e mëtejshëm të ekosistemit të pagesave, rritjen e efikasitetit dhe konkurrencës në treg, forcimin e sigurisë dhe mbrojtjes së përdoruesve të shërbimeve të pagesave, si dhe krijimin e kushteve për integrim gradual dhe unifikimin e kërkesave me ato të tregut evropian të pagesave.

Ndikimet mbi buxhetin: **Ky opsion nuk sjell kosto në buxhetin e shtetit.**

#### **ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR**

*Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.*

## **Opsioni i preferuar është Opsioni 2 - Kryerja e ndryshimeve në ligjin aktual**

**Opsioni 2** vlerësohet si opsioni më i përshtatshëm për t'u zbatuar, pasi siguron një ndërhyrje të balancuar dhe proporcionale në kuadrin ligjor ekzistues, mundëson harmonizimin e mëtejshëm me *acquis* të Bashkimit Evropian dhe ruan vazhdimësinë rregullatore për subjektet e tregut. Nga zbatimi i këtij opsioni parashikohet të realizohen përfitimet si më poshtë vijon:

- Forcimi i kuadrit ligjor dhe harmonizimi i dispozitave të ligjit nr. 55/2020 me variantin më të fundit (të konsoliduar) të direktivës për shërbimet e pagesave dhe me direktivën e parasë elektronike, duke siguruar në këtë mënyrë përafrimin e plotë të tyre sipas standardeve dhe kërkesave më të fundit evropiane dhe duke mundësuar plotësimin e një prej angazhimeve institucionale në kuadër të integritimit evropian;
- Forcimi i transparencës dhe rritja e nivelit të sigurisë në kryerjen e pagesave dhe emetimin e parasë elektronike;
- Përmirësimi i kërkesave dhe mekanizmave për mbrojtjen e përdoruesve të shërbimeve të pagesave dhe mbajtësve të parasë elektronike;
- Rregullimi në nivel ligjor, i kuadrit të licencimit, ushtrimit të veprimtarisë dhe mbikëqyrjes së institucioneve të parasë elektronike;
- Unifikimi i kërkesave për ofruesit e shërbimeve të pagesave dhe emetuesve të parasë elektronike, për t'i parapërgatitur për të qenë konkurrues në tregun përkatës evropian, kur Shqipëria të anëtarësohet në BE;
- Krijimi i bazës ligjore për veprimtarinë ndërkufitare të institucioneve të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike pas anëtarësimit në Bashkimin Evropian;
- Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe zgjerimi i aksesit në informacion për Bankën e Shqipërisë si autoritet licencues dhe mbikëqyrës.

**Kostoja e përlllogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):**

| <b>Viti 1</b>        | <b>Viti 2</b>        | <b>Viti 3</b>        |
|----------------------|----------------------|----------------------|
| <b>Nuk aplikohet</b> | <b>Nuk aplikohet</b> | <b>Nuk aplikohet</b> |

Nga analiza e kryer rezulton se opsioni i preferuar nuk sjell kosto shtesë për buxhetin e shtetit gjatë periudhës trevjeçare pas miratimit të ligjit. Kostot e mundshme për subjektet e tregut lidhen kryesisht me përshtatje organizative, procedurale dhe teknologjike, të cilat do të përballohen nga vetë subjektet në kuadër të veprimtarisë së tyre të zakonshme dhe të kërkesave të përputhshmërisë.

**KONSULTIMI**

*Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar?), çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsyet pse?)*

Projektligji është hartuar nga grupi i punës i krijuar nga Zëvendësguvernatori i Dytë i Bankës së Shqipërisë, me përfaqësues të departamenteve të ndryshme (Departamenti i Mbikëqyrjes, Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës, Departamenti Juridik dhe Kabineti i Guvernatorit). Grupi i punës është mbështetur edhe nga ekspertiza e ofruar nga Banka Botërore.

Banka e Shqipërisë e publikoi projektligjin për konsultim në faqen e saj zyrtare në fund të muajit mars 2026 dhe, njëkohësisht, zhvilloi komunikim shkresor me subjektet e ligjit, përfshirë bankat, institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike. Një pjesë e subjekteve paraqitën komente gjatë muajit prill 2026. Komentet u analizuan nga strukturat përgjegjëse dhe, për secilin sugjerim, u përgatit arsyetimi për pranimin ose mospranimin e tij.

Përveç RENJK si metoda të konsultimit publik janë përdorur gjithashtu shkresë zyrtare, *email*, publikimi në faqen zyrtare të internetit të Bankës së Shqipërisë. Njëpërmjet këtyre metodave projektligji është konsultuar si vijon me:

Banka: (11)

1. Banka Amerikane e Investimeve
2. Banka Credins
3. Banka e Bashkuar e Shqipërisë
4. Banka e Parë e Investimeve Albania
5. Banka Intesa Sanpaolo Albania
6. Banka Kombëtare Tregtare
7. Banka OTP Albania
8. Banka ProCredit
9. Banka Raiffeisen
10. Banka Tirana
11. Banka Union

Institucione të pagesave (4):

1. AK Invest sh.a
2. MPay sh.p.k
3. RAEA Financial Services sh.p.k
4. SHKK Fed Invest

Institucione të parasë elektronike (10):

1. Unioni Financiar Tiranë sh.a

2. Posta Shqiptare sh.a
3. Easypay sh.p.k
4. Paysera Albania sh.p.k
5. eReja sh.p.k
6. Rpay sh.p.k
7. Rubicon sh.a
8. Iute Pay sh.p.k
9. BKT Pay sh.a
10. Happy Pay sh.a

### Publiku i gjerë

Një pjesë e konsiderueshme e komenteve të subjekteve (kryesisht institucioneve të pagesave dhe të parasë elektronike, por edhe disa bankave) konsistonin në kërkesa për sqarime të mëtejshme të disa dispozitave të shtuara apo të rishikuara ligjore. Për këtë, janë bërë edhe sqarimet përkatëse për subjektet. Konkretisht nga metodat e tjera të referuara si më lartë ka pasur 59 komente nga subjektet, prej të cilave 49 ishin kërkesa për sqarim. Dhënë sqarimet përkatëse (për 49 komente), si dhe aty ku ishte e mundur përmirësuar parashikimet ligjore ku janë pranuar komentet plotësisht/pjesërisht dhe për rastet e tjera që nuk janë marrë parasysh janë dhënë argumentet përkatëse.

Në vijim gjendet një përmbledhje e komenteve kryesore të subjekteve, sipas tipologjisë së tyre.

#### **1. Licencimi, forma juridike dhe kapitali fillestar**

Subjektet sugjeruan zbatimin proporcional të kërkesave për institucionet e parasë elektronike (IPE) dhe institucionet e pagesave (IP), si dhe parashikimin e niveleve të kapitalit fillestar, drejtpërdrejt në ligj. Banka e Shqipërisë i ka sqaruar subjektet se kërkesat zbatohen njëloj për të gjithë subjektet, me përjashtim të atyre që plotësojnë kushtet specifike të krerëve përkatës për të përfituar nga përjashtimet. Gjithashtu, subjektet u sqaruan se nivelet e kapitalit fillestar që do të vijojnë të jenë të zbatueshme deri në anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian janë të parashikuara në rregulloren 59/2021“Për licencimin e institucioneve të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike, si dhe për regjistrimin e ofruesve të shërbimeve të pagesave”. Kur Shqipëria të jetë shtet anëtar, për t’u licencuar nga Banka e Shqipërisë, subjekti do të plotësojë nivelet e parashikuara në ligj.

Subjektet sugjeruan që ndryshimet në formën juridike ose në emërtimin e institucionit t’i nënshtrohen vetëm detyrimit për njoftim dhe të mos kërkojnë miratim paraprak, përveç rasteve kur këto ndryshime sjellin ndikim material në strukturën e pronësisë ose në profilin e riskut të institucionit. Lidhur me këtë koment, sugjerimi u pranua pjesërisht, duke rishikuar dispozitën përkatëse që ndryshimet e emrit/formës do të kërkojnë njoftim, por ndryshimi i formës juridike nga sh.p.k. në sh.a. do të kërkojë miratimin e Bankës së Shqipërisë, e cila

do ta bazojë vendimin e saj për dhënien ose jo të miratimit, duke konsideruar volumin e veprimtarisë, kompleksitetin ose strukturën e subjektit.

## **2. Veprimtaria ndërkuftare (*passporting*) dhe ndarja e kompetencave mbikëqyrëse**

Disa subjekte shprehën paqartësi mbi regjimin e *passporting* dhe bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve. Banka e Shqipërisë sqaroi se ndarja e kompetenca mbikëqyrëse në rastin e veprimtarisë ndërkuftare, parashikohen qartë në nenet 26/1–26/8 sipas ndryshimeve të propozuara të ligjit për institucionet e pagesave dhe në nenet 28/1 dhe 28/6–28/7 për institucionet e parasë elektronike, në përputhje me Direktivat PSD2 dhe 2009/110/KE. Gjithashtu u sqaruan subjektet se mekanizmi i *passporting* do të aktivizohet pas anëtarësimit të Shqipërisë në BE, ndërsa deri atëherë nëse do të ketë praktika për hapjen e degëve të këtyre institucioneve nga shtete të BE, ato do t'i nënshtrohen të njëjtave kërkesa dhe ndjekin procedurat normale të miratimit si degët e vendeve të treta.

## **3. Mbrojtja e fondeve të përdoruesve**

Disa subjekte propozuan mundësinë e depozitimit të fondeve për qëllime të mbrojtjes së tyre, edhe në banka (institucione krediti) të shteteve anëtare të BE-së. Banka e Shqipërisë pranoi pjesërisht sugjerimin, duke bërë një riformulim të kërkesës përkatëse, ku deri në anëtarësim, fondet do të vijojnë të mbrohen vetëm pranë bankave (institucioneve të kreditit) në Shqipëri ose në Bankën e Shqipërisë, sipas diskrecionit të kësaj të fundit, dhe pas anëtarësimit të lejohet edhe depozitimi në banka (institucione krediti) të shteteve anëtare, ose në banka qendrore të shteteve anëtare, sipas diskrecionit të tyre. Ky rishikim vjen edhe në linjë me parashikimet e Direktivës PSD3 për këtë çështje, që pritet të miratohet në shpejti në BE.

## **4. Paraja elektronike — emetimi, ripagimi dhe tarifat**

Subjektet ngritën pyetje mbi kohën e mbrojtjes së fondeve në këmbim të parasë elektronike të emetuar dhe Banka e Shqipërisë i sqaroi se afati 5-ditor për mbrojtjen e fondeve vlen vetëm kur pagesa bëhet me instrument pagese dhe jo në rastet kur fondet merren në para fizike (*cash*). Gjithashtu subjektet pyetën mbi zbatimin praktik të tarifave proporcionale në rastin e ripagimit të fondeve, ndërsa Banka e Shqipërisë sqaroi se çdo tarifë ripagimi duhet të jetë transparente, e justifikueshme dhe proporcionale me kostot reale të emetuesit — pa imponuar tarifa të paracaktuara, por duke pasur mundësinë për të provuar para autoritetit mbikëqyrës këto kosto reale.

## **5. Përfjashtimet, subjektet e vegjël dhe konkurrenca**

Disa operatorë ekzistues shprehën shqetësim se regjimi i përfjashtimeve (nenet 27–28 të ligjit) favorizon hyrjen e aktorëve të rinj dhe të huaj me kushte më të lehta. Banka e Shqipërisë sqaroi se këto parashikime janë në përputhje me Direktivat e BE-së dhe se përfjashtimet janë të kushtëzuara nga volumet e veprimtarisë, duke mos i përfjashtuar

subjektet plotësisht nga kërkesat e ligjit dhe nga mbikëqyrja. U theksua se subjektet ekzistuese dhe të reja i nënshtrohen të njëjtave rregulla kur plotësohen kushtet e njëjta.

## **6. Sanksionet, raportimi dhe çështje të tjera procedurale**

Bankat sugjeruan anonimizim të sanksioneve sipas parashikimeve të nenit 95 të ligjit, ndërsa Banka e Shqipërisë sqaroi se neni 95 për publikimin e sanksioneve është dispozitë ekzistuese dhe nuk ndryshon sipas projektligjit në fjalë dhe se kjo kërkesë është në përputhje të plotë me Direktivën PSD2. Subjektet sugjeruan thjeshtim të referencave ndaj akteve të BE-së, ndërsa u sqaruan se referencat ndaj *acquis* synojnë lehtësimin e përafrimit. Lidhur me paqartësitë në kërkesat për pagesat e menjëhershme (*instant payments*) dhe kuadrin DORA, u sqarua se këto çështje do të rregullohen me akte nënligjore të posaçme, duke respektuar parimin e proporcionalitetit sipas madhësisë dhe kompleksitetit të subjekteve.

Projektligji është konsultuar nëpërmjet RENJK ku është publikuar në datën 04.05.2026 dhe ka përfunduar konsultimi në datën 01.06.2026. Nuk ka pasur asnjë koment nga qeveria/biznesi/shoqëria civile/qytetarët. Ka patur gjithsej 272 shikime.

### **ZBATIMI DHE MONITORIMI**

*Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?*

Për zbatimin e këtij ligji ngarkohen të gjitha subjektet e përcaktuara në nenin 3 të projektligjit të cilat licencohen dhe mbikëqyren nga Banka e Shqipërisë si autoriteti përgjegjës për zbatimin e këtij ligji.

Institucioni përgjegjës për monitorimin e zbatimit të këtyre ndryshimeve ligjore, do të jetë Banka e Shqipërisë, si autoriteti përgjegjës për licencimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve të pagesave dhe të parasë elektronike.

## **PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE**

Historik

- *Jepni kontekstin e politikës*

Kërkesa e Komisionit Evropian për transpozimin fillimisht të Direktivës 2007/64/EC “Për shërbimet e pagesave në tregun e brendshëm” (PSD1) ishte një kërkesë e hershme e cila fillon me analizimin dhe identifikimin e nevojave për ndërhyrje në legjislacionin vendas, pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, dhe më konkretisht në kuadër të lëvizjes së lirë të kapitalit (Kapitulli 4) nga pikëpamja e shërbimeve të pagesave dhe përafrimit të praktikave të tregut Evropian për Tregun Unik të Pagesave në Euro (*Single Euro Payment Area*). Me qëllim përmbushjen e kësaj kërkesë, Banka e Shqipërisë kishte përfshirë

transpozimin e kësaj direktive në strategjinë e saj afatmesme që prej vitit 2011. Por meqenëse Komisioni Evropian në vitin 2012-2013 kishte iniciuar procesin e rishikimit të Direktivës, që u finalizua me prezantimin e Direktivës 2015/2366/EU (PSD2) dhe që hyri në fuqi për vendet anëtare në janar të vitit 2018, u dakordësua që Banka e Shqipërisë të shtynte procesin e transpozimit të Direktivës PSD1, duke përafuar direkt në legjislacion, Direktivën PSD2.

Në këtë kuadër, u hartua dhe miratua ligji 55/2020 “Për shërbimet e pagesave”, i cili përafroi në shkallën më të lartë të mundshme për kohën kur u hartua, kërkesat e Direktivës PSD2. Pas miratimit të ligjit, Banka e Shqipërisë ka miratuar edhe kuadrin nënligjor, për të mundësuar zbatimin sa më efikas të ligjit, një kuadër i hartuar në përputhje me aktet përkatëse të BE-së.

Në zbatim të ligjit 55/2020 “Për shërbimet e pagesave” janë miratuar aktet e mëposhtme:

- Rregullore 59/2021 “Për licencimin e institucioneve të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike, si dhe për regjistrimin e ofruesve të shërbimeve të pagesave”;
- Udhëzim 1/2022 “Për kriteret për përcaktimin e shumës monetare minimale të siguracionit të dëmshpërblimit profesional ose të garancive të tjera të krahasueshme”;
- Rregullore 7/2022 “Për regjistrin publik të ofruesve të shërbimeve të pagesave”;
- Rregullore 29/2022 “Për autentifikimin e thelluar të klientit dhe standardet e përbashkëta, të hapura dhe të sigurta të komunikimit”;
- Rregullore 57/2022 “Për ushtrimin e veprimtarisë dhe mbikëqyrjen e institucioneve të parasë elektronike”;
- Rregullore 59/2022 “Për krahasueshmërinë e tarifave të lidhura me llogaritë e pagesave dhe për shërbimin e transferimit të llogarive të pagesave”;
- Rregullore 14/2023 “Për ushtrimin e veprimtarisë dhe mbikëqyrjen e institucioneve të pagesave”;
- Udhëzim 10/2024 “Për raportimin e incidenteve madhore”;
- Rregullore 43/2024 “Për informacionin që shoqëron transfertat e fondeve”;
- Rregullore 51/2024 “Për administrimin e rrezikut operacional nga bankat, institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike”.

## **Problemi në shqyrtim**

- *Përshkruani natyrën e problemit.*

Kuadri ligjor bazë shqiptar për shërbimet e pagesave u krijua me miratimin e ligjit nr. 55/2020 “Për shërbimet e pagesave”. Ky ligj mundësoi transpozimin e një pjese të konsiderueshme të kërkesave të Direktivës (BE) 2015/2366 (PSD2), duke krijuar bazën rregullatore për licencimin, mbikëqyrjen dhe ushtrimin e veprimtarisë së institucioneve të pagesave si dhe më gjerë, për ofrimin e shërbimeve të pagesave në Republikën e Shqipërisë. Megjithatë, në vijim të procesit të integritimit evropian dhe të zhvillimeve të viteve të fundit në legjislacionin e Bashkimit Evropian, janë konstatuar disa problematika të rëndësishme dhe të ndërlydhura, të cilat bëjnë të domosdoshme ndërmarrjen e kësaj nisme ligjore.

## **Mungesa e harmonizimit të plotë me kërkesat e Direktivës PSD2 dhe ndryshimet pasuese të saj**

Ligji nr. 55/2020 “Për shërbimet e pagesave” është një bazë shumë e rëndësishme për rregullimin e tregut shqiptar të pagesave dhe për përafrimin e tij me standardet e BE-së. Problematika e parë e identifikuar lidhet me faktin se ligji nr. 55/2020 nuk është harmonizuar në mënyrë të plotë me kërkesat e Direktivës 2015/2366/BE, dhe as nuk pasqyron ndryshimet e mëvonshme që i janë bërë vetë Direktivës pas miratimit të tij. Konkretisht, Direktiva 2022/2556/BE e ndryshoi PSD2 duke futur kërkesa të reja lidhur me qëndrueshmërinë operacionale digjitale (*Digital Operational Resilience – DORA*), duke i kërkuar ofruesve të shërbimeve të pagesave të zbatojnë standarde të larta për menaxhimin e rrezikut të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), për testimin e sistemeve dhe raportimin e incidenteve madhore pranë autoritetit mbikëqyrës. Ndërkohë, Rregullorja 2024/886/BE ndryshoi PSD2 lidhur me mënyrat e mbrojtjes së fondeve të klientëve, si dhe me kushtet e pjesëmarrjes në sisteme pagesash që rregullohen sipas finalitetit të shlyerjes. Konkretisht këto kërkesa lidhen me aspekte të tilla si forcimi i qëndrueshmërisë operacionale digjitale, menaxhimi i rrezikut të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, si dhe rregullat për mbrojtjen e fondeve të klientëve. Mungesa e pasqyrimin të këtyre elementeve në legjislacionin kombëtar krijon boshllëqe rregullatore dhe ndikon në nivelin e përafrimit me standardet e Bashkimit Evropian.

## **Mungesa e dispozitave ligjore për veprimtarinë ndërkufitare dhe mekanizmin e “*passporting*”**

Kuadri aktual ligjor nuk parashikon në mënyrë të plotë dispozita që rregullojnë veprimtarinë ndërkufitare të institucioneve të pagesave dhe të parasë elektronike, përfshirë të drejtën e ofrimit të shërbimeve dhe lirinë e vendosjes në shtete të tjera, si dhe mekanizmin e “*passporting*”-ut. Kjo mungesë krijon një boshllëk rregullator në raport me kërkesat e *acquis* të Bashkimit Evropian dhe kufizon qartësinë juridike për ushtrimin e veprimtarisë ndërkufitare të këtyre institucioneve, veçanërisht në kontekstin e procesit të integritimit evropian.

Sipas Direktivës PSD2 dhe EMD2, ky mekanizëm u mundëson ofruesve të shërbimeve të licencuar në një shtet anëtar të BE-së, që të ushtrojnë veprimtari edhe në shtetet e tjera anëtare pa pasur nevojë për licencim të ri, duke u mbështetur vetëm në autorizimin e dhënë nga shteti i origjinës (i njohur si “licencë e vetme evropiane”). Ligji nr. 55/2020 nuk përfshiu këto dispozita, pasi në kohën e hartimit të tij Shqipëria nuk ishte shtet anëtar i BE-së dhe kërkesa e tillë nuk ishte ende relevante operacionalisht. Gjithashtu, ligji aktual nuk parashikon as hapjen e degëve të institucioneve shqiptare në vende të treta jashtë BE-së, gjë që kufizon zgjerimin ndërkombëtar të subjekteve të licencuara nga Banka e Shqipërisë edhe jashtë kontekstit të integritimit evropian, ose të degëve të institucioneve nga vende të treta në Shqipëri. Pjesë e këtyre dispozitave që nevojitet të përafrohen janë edhe parashikimet për bashkëpunimin e Bankës së Shqipërisë me autoritetet homologe të shteteve të tjera anëtare, në kuadër të licencimit dhe mbikëqyrjes së subjekteve që përfitojnë nga mekanizmi “*passporting*”.

## **Mungesa e rregullimit në nivel ligjor për institucionet e parasë elektronike**

Problematika e tretë lidhet me faktin se kuadri aktual ligjor nuk rregullon në nivel të aktit ligjor, licencimin, ushtrimin e veprimtarisë dhe mbikëqyrjen e institucioneve të parasë elektronike. Direktiva 2009/110/KE (EMD2) rregullon institucionet e parasë elektronike në nivel evropian dhe parashikon kërkesat për licencimin, kapitalin minimal, mbrojtjen e fondeve të mbajtura të parasë elektronike, kushtet e ripagimit të parasë elektronike, detyrimet mbi transparencën dhe masat administrative. Deri më tani, një pjesë e konsiderueshme e kërkesave të kësaj Direktive është adresuar kryesisht nëpërmjet akteve nënligjore të Bankës së Shqipërisë, të cilat, megjithëse të rëndësishme, janë akte nënligjore dhe nuk sigurojnë të njëjtin nivel mbrojtjeje juridike dhe qëndrueshmërie normative. Kjo qasje nuk siguron të njëjtin nivel sigurie juridike, qëndrueshmërie normative dhe uniformiteti rregullator si rregullimi në nivel ligjor.

Gjithashtu, zhvillimi i shpejtë i tregut të parasë elektronike në Shqipëri – me rritje të ndjeshme të numrit të subjekteve të licencuara dhe volumit të transaksioneve gjatë viteve 2021–2024 ka sjellë nevoja rregullatore të reja që nuk mund të adresohen vetëm nëpërmjet kuadrit nënligjor ekzistues.

## **Pamjaftueshmëria e mbrojtjes së konsumatorëve dhe transparencës në kostot e pagesave**

Problematika e katërt lidhet me pamjaftueshmërinë e mekanizmave ligjorë për mbrojtjen e konsumatorëve dhe transparencën në kostot e shërbimeve të pagesave. Aktualisht, ligji nr. 55/2020 nuk parashikon kërkesa për vendosjen e kufijve mbi tarifën e shkëmbimit (*interchange fees*) për transaksionet e bazuara në kartë. Në kuadrin e BE-së, Rregullorja (BE) 2015/751 vendos kufij të qartë për këto tarifa (0.2% për kartat e debitit dhe 0.3% për kartat e kreditit), me qëllim uljen e kostove për tregtarët dhe, indirekt, për konsumatorët fundorë. Mungesa e një dispozite të tillë në ligjin shqiptar ka lënë hapësirë për vendosjen e tarifave të ndryshme të ndërmjetësimit nga subjektet, duke rënduar kostot operative të bizneseve, sidomos ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, dhe duke frenuar adoptimin më të gjerë të pagesave elektronike.

Kuadri aktual ligjor nuk parashikon në mënyrë të plotë kërkesa të posaçme për transparencën ndaj përdoruesve të shërbimeve të pagesave në rastet e transaksioneve në monedha të ndryshme, në përputhje me standardet e *acquis* të Bashkimit Evropian dhe Direktivës (BE) 2015/2366 (PSD2). Kjo mungesë krijon boshllëqe në informacionin e ofruar për përdoruesit dhe nuk siguron një nivel të unifikuar transparence në përputhje me zhvillimet e tregut dhe procesin e integritet evropian.

## **Mangësi në zbatueshmërinë e dispozitave ligjore dhe efektivitetin e sanksioneve**

Kuadri aktual ligjor parashikon masa administrative dhe gjoha, si dhe kompetenca mbikëqyrëse të autoritetit përgjegjës, por këto dispozita rezultojnë të pamjaftueshme për të garantuar një regjim sanksionesh plotësisht efektiv, proporcional dhe me efekt parandalues. Në veçanti, niveli dhe struktura e gjobave, si dhe specifikimi i masave korrigjuese dhe administrative, nuk sigurojnë një shkallë të mjaftueshme disuazive ndaj shkeljeve të dispozitave ligjore dhe nënligjore, në përputhje me parimet e së drejtës së Bashkimit Evropian.

Mos-adresimi i problematikave të identifikuara do të rezultonte: (i) në pamundësi të plotësimi të piketave mbyllëse të Kapitullit 4; (ii) në vonesë të integritit të ofruesve shqiptarë të shërbimeve të pagesave në tregun e përbashkët evropian; (iii) në mbrojtje të pamjaftueshme të konsumatorëve dhe mikrondërmarrjeve; dhe (iv) në efikasitet të reduktuar të mbikëqyrjes nga Banka e Shqipërisë. Prandaj, ndërhyrja ligjore e propozuar është e nevojshme dhe e domosdoshme.

- *Identifikoni shkaqet e problemit.*

Shkaqet kryesore të problematikave të evidentuara më lart lidhen kryesisht me zhvillimet e fundit në legjislacionin e Bashkimit Evropian, lidhen me zhvillimet e mëtejshme të legjislacionit të Bashkimit Evropian në këtë fushë krahasuar me legjislacionin tone në fuqi, të cilat kanë krijuar një hendek ndërmjet kuadrit rregullator aktual dhe standardeve më të fundit evropiane, si dhe me sfidat e hasura në zbatimin praktik të ligjit aktual.

Procesi i integritit evropian i Shqipërisë kërkon përafrimin e vazhdueshëm të legjislacionit kombëtar me atë të Bashkimit Evropian. Për këtë arsye, përditësimi i ligjit për shërbimet e pagesave është i domosdoshëm për të siguruar përputhshmërinë me *acquis* të BE-së dhe për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga procesi i integritit, në kuadër të kapitullit 4 “Lëvizja e lirë e kapitalit”.

Kuadri ligjor aktual nuk përfshin në mënyrë të plotë kërkesat dhe standardet e reja evropiane në fushën e shërbimeve të pagesave dhe të parasë elektronike që synojnë forcimin e sigurisë kibernetike, rritjen e rezistencës së institucioneve financiare ndaj incidenteve teknologjike dhe garantimin e ofrimit të pagesave të menjëhershme në mënyrë të sigurt dhe efikase. Si pasojë, krijohet një hendek ndërmjet kuadrit rregullator vendas dhe standardeve më të fundit të Bashkimit Evropian, duke kufizuar harmonizimin e tregut shqiptar të pagesave me zhvillimet evropiane dhe duke penguar përfitimin e plotë nga inovacioni dhe modernizimi i shërbimeve të pagesave.

Një shkak tjetër lidhet me **zgjerimin e kategorive të ofruesve të shërbimeve të pagesave dhe të parasë elektronike**, të cilat në kuadrin aktual nuk pasqyrohen në mënyrë të plotë në legjislacion, duke krijuar mungesë qartësie në trajtimin dhe mbikëqyrjen e tyre.

Gjithashtu, vërehet **nevoja për përditësimin e përkufizimeve ligjore dhe harmonizimin terminologjik**, pasi një pjesë e koncepteve kyçe (si “institucion pagese”, “institucion i parasë elektronike”, “transaksion ndërkufitar”, etj.) janë riformuluar në kuadrin e ri dhe kërkojnë reflektim edhe në legjislacionin për sistemet e pagesave, për të shmangur interpretimet e ndryshme.

Një faktor tjetër është **rritja e kompleksitetit të operacioneve dhe ndërveprimet ndërkufitar**, për shkak të ofrimit të shërbimeve në më shumë se një juridiksion dhe nevojës për bashkëpunim ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse, çka kërkon një bazë më të qartë dhe të harmonizuar ligjore që do të jetë e aplikueshme me anëtarësimin.

Një shkak shtesë lidhet me **nevojën për forcimin e mekanizmave të mbikëqyrjes dhe shkëmbimit të informacionit**, në mënyrë që autoritetet përgjegjëse të kenë mundësi të ushtrojnë në mënyrë efektive funksionet e tyre në një treg gjithnjë e më të ndërlidhur dhe teknologjikisht të avancuar.

Në kuadër të zhvillimit të tregut të institucioneve të parasë elektronike , një shkak tjetër lidhet me faktin se kuadri ligjor në fuqi nuk përmban dispozita të plota dhe të detajuara për licencimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve të parasë elektronike, në përputhje me zhvillimin e këtij tregu dhe standardet më të fundit rregullatore. Kjo krijon boshllëqe në rregullimin e veprimtarisë së këtyre institucioneve dhe evidenton nevojën për përmirësimin e kuadrit ligjor, me qëllim garantimin e një mbikëqyrjeje më efektive, mbrojtjen e përdoruesve dhe funksionimin e sigurt të tregut.

- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*

Shtrirja e problemit përfshin të gjithë sektorin e shërbimeve të pagesave dhe të parasë elektronike në Republikën e Shqipërisë, duke ndikuar tek institucionet e pagesave, institucionet e parasë elektronike, bankat që ofrojnë shërbime pagesash, si dhe përdoruesit e këtyre shërbimeve.

Konkretisht problemi shtrihet në disa drejtime kryesore. Së pari, kuadri aktual ligjor nuk përfshin kërkesat për të drejtën e ofrimit të shërbimeve apo lirinë e vendosjes të institucioneve të pagesave dhe të parasë elektronike në shtete të ndryshme anëtare (“*passporting*”). Mungesa e këtyre dispozitave kufizon mundësinë e këtyre subjekteve për të operuar në mënyrë ndërkufitare dhe për t’u integruar në tregun e përbashkët evropian, duke krijuar një pengesë strukturore në perspektivën e anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Së dyti, kuadri ekzistues nuk përmban kërkesat e reja të Direktivës PSD2 (të shtuara në Direktivë në vitin 2022 dhe 2024) që lidhen me qëndrueshmërinë operationale digjitale dhe pagesat e menjëhershme, të cilat tashmë përbëjnë një komponent të rëndësishëm në Bashkimin Evropian. Mungesa e këtyre kërkesave në legjislacionin kombëtar do të krijonte një hendek ndërmjet standardeve të aplikueshme në Shqipëri dhe atyre të kërkuara nga Bashkimi Evropian.

Së treti, shtrirja e problemit lidhet edhe me kategoritë e subjekteve që do të jenë zbatuese të ligjit, të cilat do të jenë më të gjera kur Shqipëria të anëtarësohet në BE. Legjislacioni aktual nuk parashikon në mënyrë të plotë trajtimin e këtyre kategorive të reja apo ndërveprimin e tyre me sistemet e pagesave, duke krijuar boshllëqe rregullatore dhe paqartësi në zbatim, si për subjektet e tregut ashtu edhe për autoritetet mbikëqyrëse.

*Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*

Grupet e prekura nga ky problem janë si vijon:

- Qeveria dhe institucionet publike, veçanërisht Banka e Shqipërisë si autoritet licencues dhe mbikëqyrës, si dhe institucionet përgjegjëse për procesin e integrimit evropian dhe harmonizimin e legjislacionit me *acquis* të Bashkimit Evropian.

Këto institucione preken drejtpërdrejt nga problematika e identifikuar, pasi janë përgjegjëse për hartimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e kuadrit ligjor në fushën e shërbimeve të pagesave. Mungesa e harmonizimit të plotë të legjislacionit vendas me *acquis* të Bashkimit Evropian krijon vështirësi veçanërisht në drejtim të licencimit dhe mbikëqyrjes së subjekteve. Për Bankën e Shqipërisë, kjo situatë reflektohet në një kompleksitet më të lartë në interpretimin e dispozitave ekzistuese dhe në kufizime për të ushtruar një mbikëqyrje të integruar dhe në përputhje me standardet më të avancuara evropiane.

Në të njëjtën kohë, institucionet përgjegjëse për procesin e integrimit evropian përballen me sfida në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga përafrimi i legjislacionit kombëtar me kuadrin e BE-së. Hendeku ndërmjet kuadrit aktual dhe zhvillimeve të fundit në *acquis*, si në drejtim të “*passporting*”, qëndrueshmërisë operacionale digjitale apo pagesave të menjëhershme, ndikon në progresin e vendit drejt integrimit dhe kërkon ndërhyrje të vazhdueshme për harmonizim.

- Bizneset, duke përfshirë bankat, institucionet e pagesave, institucionet e parasë elektronike, ofruesit e shërbimeve teknologjike të lidhura me pagesat dhe subjektet e tjera që përdorin ose ofrojnë shërbime pagesash në kuadër të veprimtarisë së tyre ekonomike.
- **Bankat** preken drejtpërdrejt nga kjo problematikë për shkak të rolit të tyre si ofrues kryesorë të shërbimeve të pagesave dhe pjesëmarrës në sistemet e pagesave. Mungesa e një kuadri të harmonizuar me standardet e BE-së krijon pasiguri juridike dhe rrit kompleksitetin në përmbushjen e kërkesave rregullatore, veçanërisht në drejtim të operacioneve ndërkufitare dhe integrimit me tregjet evropiane.
- **Institucionet e pagesave** ndikohen në mënyrë të konsiderueshme, pasi zhvillimi i aktivitetit të tyre lidhet ngushtë me aksesin në infrastrukturën e pagesave dhe qartësinë e rregullave të tregut. Kuadri i pa përditësuar kufizon inovacionin, hyrjen në treg dhe zgjerimin e aktivitetit, si dhe krijon barriera për përputhshmërinë me kërkesat e reja evropiane.
- **Institucionet e parasë elektronike** përballen me sfida të ngjashme, sidomos në drejtim të rregullimit të veprimtarisë së tyre dhe integrimit me sistemet e pagesave. Mungesa e përafrimit me standardet e BE-së kufizon zhvillimin e produkteve digjitale dhe ofrimin e shërbimeve në mënyrë të sigurt dhe të krahasueshme me tregjet evropiane.
- **Ofruesit e shërbimeve teknologjike të lidhura me pagesat** (fintech, IT, operatorë platformash) preken për shkak se kuadri aktual nuk adreson në mënyrë të plotë rolin dhe ndërveprimin e tyre me institucionet financiare dhe sistemet e pagesave. Kjo krijon

pasiguri për investimet dhe zhvillimin e zgjidhjeve të reja teknologjike, si dhe kufizon potencialin për inovacion.

- **Subjektet e tjera që përdorin ose ofrojnë shërbime pagesash në kuadër të aktivitetit të tyre ekonomik** preken në nivel praktik, pasi mungesa e një kuadri të qartë dhe modern ndikon në efikasitetin e proceseve të pagesave, rrit kostot operacionale dhe kufizon aksesin në shërbime më të avancuara dhe të sigurta, veçanërisht në kontekstin e digjitalizimit dhe integritit me tregjet ndërkombëtare.
- Qytetarët, në cilësinë e përdoruesve të shërbimeve të pagesave dhe të parasë elektronike, të cilët ndikohen nga niveli i sigurisë, cilësisë, transparencës, kostove dhe aksesit në këto shërbime.
- **Qytetarët**, në cilësinë e përdoruesve të shërbimeve të pagesave dhe të parasë elektronike, preken drejtpërdrejt nga niveli i zhvillimit dhe harmonizimit të kuadrit ligjor, pasi ai ndikon në sigurinë, cilësinë dhe transparencën e shërbimeve që ata përdorin. Mungesa e përafrimit me standardet evropiane mund të sjellë kufizime në aksesin ndaj shërbimeve moderne, si pagesat e menjëhershme, si dhe të ndikojë në rritjen e kostove dhe pasigurisë në kryerjen e transaksioneve. Një kuadër i pa përditësuar gjithashtu mund të kufizojë mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve dhe besimin e tyre në sistemin financiar.
- Shoqëria civile dhe organizatat e mbrojtjes së konsumatorit, të cilat kanë interes në garantimin e mbrojtjes së të drejtave të përdoruesve, sigurisë së shërbimeve financiare dhe rritjes së transparencës në treg.
- **Shoqëria civile dhe organizatat e mbrojtjes së konsumatorit** preken në aspektin e rolit të tyre në garantimin e mbrojtjes së interesave të përdoruesve dhe rritjes së transparencës në treg. Mungesa e një kuadri të plotë dhe të harmonizuar me standardet e BE-së e vështirëson monitorimin efektiv të praktikave të tregut dhe adresimin e problematikave që lidhen me sigurinë, tarifat apo cilësinë e shërbimeve. Kjo situatë kufizon gjithashtu mundësinë e tyre për të kontribuar në mënyrë të informuar në proceset e konsultimit publik dhe në përmirësimin e politikave në fushën e shërbimeve të pagesave.
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Problemi i identifikuar, që lidhet me nevojën për përditësimin dhe përafrimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor për shërbimet e pagesave me legjislationin e Bashkimit Evropian, përfshirë edhe zhvillimet e fundit të tij, mund të trajtohet në mënyrë efektive përmes ndërhyrjes në nivel politikash.

Kuadri aktual i ligjit 55/2020 “Për shërbimet e pagesave” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ka krijuar një bazë të rëndësishme për rregullimin e tregut të shërbimeve të pagesave dhe emetimit të parasë elektronike në vend. Megjithatë, zhvillimet e fundit në nivel të Bashkimit

Evropian, veçanërisht në lidhje pagesat e menjëhershme dhe qëndrueshmërinë operacionale digjitale, rishikimi i kërkesave për transparencë dhe siguri ndaj klientëve, dhe parashikimi i kërkesave për lirinë e ofrimit të shërbimeve, kanë sjellë nevojën për përditësimin e tij.

### **Arsyeja e ndërhyrjes**

- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme:*

Nevoja për përafrim të praktikave evropiane në tregun vendas të pagesave dhe të parasë elektronike është një angazhim i ndërmarrë nga Shqipëria me nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit dhe më konkretisht përbën një kërkesë të vazhdueshme të Bashkimit Evropian në kuadër të kapitullit 4 “Lëvizja e lirë e kapitalit”.

Në kuadër të angazhimit të marrë nga shteti shqiptar për anëtarësimin në BE, dhe më konkretisht bazuar në piketat mbyllëse të Kapitullit 4 për përputhshmërinë e plotë të kuadrit ligjor shqiptar me atë të BE-së në fushën e shërbimeve të pagesave dhe emetimit të parasë elektronike, duke konsideruar edhe zhvillimet më të fundit në legjislacionin e BE-së në këto fusha, lind nevoja për ndërhyrjen e qeverisë. Kjo ndërhyrje synon të rrisë sigurinë, transparencën e shërbimeve të pagesave dhe të parasë elektronike dhe të përgatisë gradualisht aktorët për të konkurruar në tregun e përbashkët evropian të pagesave dhe të parasë elektronike, pas anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Referuar sa më lartë, qeveria planifikon të ndërhyjë për shkak të nevojës për përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit kombëtar me *acquis* të Bashkimit Evropian në fushën e shërbimeve të pagesave dhe parasë elektronike. Kuadri aktual ligjor paraqet boshllëqe të rëndësishme në raport me zhvillimet më të fundit evropiane, veçanërisht në drejtim të lirisë së ofrimit të shërbimeve (“*passporting*”), qëndrueshmërisë operacionale digjitale dhe zhvillimit të pagesave të menjëhershme. Në mungesë të një ndërhyrjeje të tillë, ekziston rreziku i rritjes së hendekut ndërmjet legjislacionit vendas dhe atij të BE-së, duke ndikuar negativisht në procesin e integritimit dhe në funksionimin e tregut financiar.

Gjithashtu, ndërhyrja është e nevojshme për të adresuar paqartësitë dhe mospërputhjet ekzistuese në kuadrin rregullator, të cilat ndikojnë në efektivitetin e mbikëqyrjes dhe në sigurinë juridike të subjekteve. Një kuadër më i qartë dhe i harmonizuar mundëson ushtrimin më efikas të funksioneve të Bankës së Shqipërisë si autoritet licencues dhe mbikëqyrës, si dhe kontribuon në krijimin e një mjedisi më të qëndrueshëm dhe të parashikueshëm për zhvillimin e tregut të shërbimeve të pagesave.

Përveç aspektit të harmonizimit ligjor, ndërhyrja është e nevojshme edhe për të adresuar sfidat që lidhen me transformimin digjital të sektorit financiar dhe me rritjen e përdorimit të

shërbimeve elektronike të pagesave. Zhvillimet teknologjike kanë sjellë modele të reja biznesi, aktorë të rinj në treg dhe rreziqe të shtuara në fushën e sigurisë kibernetike dhe qëndrueshmërisë operationale. Kuadri ekzistues nuk i adreson në mënyrë të plotë këto zhvillime, duke kufizuar mundësinë për inovacion dhe duke mos garantuar të njëjtin nivel mbrojtjeje për përdoruesit si ai i parashikuar në legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Gjithashtu, ndërhyrja synon të krijojë kushtet për një treg pagesash më konkurrues, më efikas dhe më të integruar. Mungesa e rregullave të harmonizuara për pagesat e menjëhershme, aksesin ndërkuftar në treg dhe mbikëqyrjen e ofruesve të shërbimeve të pagesave mund të pengojë zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve të reja financiare, si dhe të kufizojë përfitimet që konsumatorët dhe bizneset mund të marrin nga një treg modern pagesash. Për rrjedhojë, ndërhyrja e qeverisë konsiderohet e domosdoshme për të siguruar përputhshmërinë me standardet evropiane, për të rritur besimin në sistemin e pagesave dhe për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm të tregut financiar në Shqipëri.

Në mungesë të kësaj ndërhyrjeje, institucionet financiare dhe ofruesit e shërbimeve të pagesave do të vazhdonin të operonin mbi një kuadër rregullator që nuk reflekton plotësisht standardet dhe kërkesat aktuale të Bashkimit Evropian. Kjo do të krijonte pengesa për integrimin e tregut shqiptar të pagesave me tregun evropian, do të kufizonte mundësitë për ofrimin e shërbimeve ndërkuftare dhe do të reduktonte aftësinë konkurruese të operatorëve vendas në perspektivën e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Për këtë arsye, ndërhyrja paraqitet si masa më e përshtatshme për të garantuar zhvillimin e mëtejshëm të tregut, mbrojtjen e përdoruesve dhe përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritit evropian.

Në kuadër të nismave kombëtare për reduktimin e *cash*-it, ulja e kostove për konsumatorët dhe rrjedhimisht rritja e përdorimit të pagesave elektronike pritet të ketë një kontribut të rëndësishëm në arritjen e objektivit për uljen e nivelit të përdorimit të *cash*-it në ekonomi.

Sot, me përparimin e ndjeshëm në procesin e negociatave të anëtarësimit, parashikimi paraprak i këtij kuadri ka rëndësi të dyfishtë: nga njëra anë, ai i përgatit subjektet shqiptare për të shfrytëzuar menjëherë të drejtën e zgjerimit ndërkuftar sapo Shqipëria të bëhet shtet anëtar, pa pasur nevojë për ndryshime ligjore urgjente pas anëtarësimit; nga ana tjetër, ai siguron që Banka e Shqipërisë të jetë e pajisur me instrumentet e nevojshme ligjore për të vepruar si autoritet i vendit pritës ndaj subjekteve të BE-së që do të operojnë në Shqipëri nëpërmjet këtij mekanizmi, dhe si autoritet i vendit të origjinës ndaj subjekteve shqiptare që do të dëshirojnë të zgjerohen në tregjet e shteteve të tjera anëtare. Për më tepër integrimi i plotë i kërkesave të EMD2 në ligjin “Për shërbimet e pagesave” do të unifikojë trajtimin rregullator të të gjithë ofruesve të shërbimeve të pagesave dhe emetuesve të parasë elektronike, duke eliminuar pabarazinë e identifikuar dhe duke forcuar efikasitetin e mbikëqyrjes.

Integrimi në kuadër të tregut të përbashkët të pagesave (SEPA), por edhe përparimi në procesin e integritit në BE, sjell nevojën si për rritjen e kërkesave të transparencës jo vetëm për transaksionet brenda vendit, por edhe ato me vende të BE-së. Gjithashtu, përgatitja paraprake e tregut të pagesave për të qenë konkurrues në tregun e përbashkët evropian të pagesave, lind nevojën e unifikimit të kërkesave me ato të aplikueshme në BE.

Nga ana tjetër, nevoja për parashikimin në ligj edhe të dispozitave që rregullojnë të drejtën e ofrimit të shërbimeve apo lirinë e vendosjes të institucioneve të pagesave dhe të parasë elektronike në shtete të ndryshme anëtare, duke përdorur të ashtuquajturin “*passporting*”, pa qenë nevoja e licencimit në çdo shtet anëtar, duhet të adresohet nëpërmjet shtimit në ligj të këtyre dispozitave, për t’u bërë menjëherë të zbatueshme sapo Shqipëria të anëtarësohet në Bashkimin Evropian.

Gjithashtu kushtet e transparencës ndaj përdoruesve të shërbimeve të pagesave të parashikuara në ligjin aktual, nevojitet të rishikohen për të parashikuar edhe rastet e pagesave në monedha të ndryshme kur Shqipëria të anëtarësohet në BE, duke siguruar përputhshmërinë e plotë me dispozitat e Direktivës PSD2.

Rishikimi i kompetencave të autoritetit mbikëqyrës për vendosje masash korrektuese dhe sanksionesh ndaj subjekteve që shkelin dispozitat ligjore dhe nënligjore, nevojitet të bëhet nëpërmjet rritjes së nivelit të gjobave që mund të vendosen ndaj subjekteve apo personave përgjegjës për shkeljet.

- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*

Nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje, qeveria synon të trajtojë boshllëqet që lidhen me mungesën e përfshirjes së koncepteve dhe mekanizmave të rinj të përcaktuara në kuadrin evropian, duke përfshirë të drejtën e ofrimit ndërkufitar të shërbimeve, rregullimin e roleve të subjekteve të reja dhe forcimin e kërkesave për sigurinë dhe qëndrueshmërinë operacionale. Ndërhyrja synon gjithashtu të përmirësojë koherencën ndërmjet akteve ligjore ekzistuese, duke eliminuar mbivendosjet dhe paqartësitë që ndikojnë në zbatimin praktik të tyre.

Njëkohësisht, synohet krijimi i kushteve për zhvillimin e një tregu më modern, konkurrues dhe të integruar të shërbimeve të pagesave, në përputhje me standardet evropiane. Përfshirja e rregullave për pagesat digjitale dhe të menjëhershme, si dhe adresimi i kërkesave për sigurinë kibernetike dhe mbrojtjen e përdoruesve, pritet të rrisë cilësinë dhe efikasitetin e shërbimeve të ofruara, duke kontribuar në forcimin e stabilitetit financiar dhe në rritjen e besimit të publikut në sistemin e pagesave.

Ndërhyrja e qeverisë është e nevojshme për të krijuar parakushtet e nevojshme për zgjidhjen e problemeve që mbart ekonomia shqiptare nga përdorimi i lartë i *cash*-it dhe përfshirja e ulët financiare. Përdorimi i *cash*-it, ashtu sikurse është evidentuar nga studimet e Bankës së Shqipërisë, jo vetëm mbart kosto për ekonominë në tërësi dhe frenon produktivitetin efikas të agjentëve ekonomikë, por nga ana tjetër në thelb favorizon informalitetin e ekonomisë në tërësi. Nëpërmjet kësaj ndërhyrje pritet të ulen kostot për konsumatorët dhe rrjedhimisht të rritet përdorimi i pagesave elektronike dhe të ulet më tej niveli i përdorimit të *cash*-it.

Ndryshimet synojnë sigurimin e një përafrimi të plotë të legjislacionit shqiptar me *acquis* të Bashkimit Evropian në fushën e pagesave dhe parasë elektronike, duke plotësuar edhe një nga angazhimet e marra për piketat mbyllëse të Kapitullit 4 në kuadër të integritetit në BE.

Nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje, qeveria synon të krijojë edhe një treg bashkëkohor të pagesave, i cili kur Shqipëria të anëtarësohet në Bashkimin Evropian, të jetë i gatshëm dhe konkurrues në tregun e përbashkët evropian, i mbështetur nga infrastruktura të sigurta dhe eficiente, dhe nga një gamë e gjerë e instrumenteve dhe shërbimeve të pagesave që përmbushin nevojat e përdoruesve për të kryer pagesa në të gjithë vendin dhe më tej në BE.

- *Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.*

Ndërhyrja e qeverisë konsiderohet e moderuar, pasi nuk synon ndryshimin rrënjësor të tregut aktual të shërbimeve të pagesave dhe të parasë elektronike, por përmirësimin dhe përshtatjen e tij të plotë me kërkesat e Bashkimit Evropian, përfshirë edhe zhvillimet më të fundit të tyre.

- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*

Kjo ndërhyrje mbështet objektivat strategjike të qeverisë për integrimin evropian dhe për forcimin e kërkesave për institucionet financiare në vend. Në mënyrë të veçantë, ajo kontribuon në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritit në Bashkimin Evropian, konkretisht nga Kapitulli 4 i *acquis*-së “Lëvizja e lirë e kapitalit”, i cili përfshin edhe kërkesat për sistemet e pagesave, shërbimet e pagesave dhe paranë elektronike.

Kjo nismë lidhet me disa dokumente strategjike të qeverisë, siç janë:

### **Strategjia e Menaxhimit të Financave Publike (PFM)**

Kjo Strategji përfshin objektiva për uljen e përdorimit të *cash*-it në ekonomi, nxit pagesat elektronike në sektorin publik dhe privat dhe synon rritjen e transparencës dhe formalizimin fiskal.

## **2. Strategjia Kombëtare për Zhvillimin dhe Integrimin Evropian**

Kjo Strategji përcakton prioritetin e modernizimit të sistemit financiar. Gjithashtu ajo përfshin përafrimin me *acquis* të BE-së në fushën e shërbimeve të pagesave, si dhe mbështet zhvillimin e tregut digjital dhe konkurrues.

Ndryshimet e ligjit “Për shërbimet e pagesave”, janë edhe në funksion të nismës kombëtare “*Cashless Albania 2030*”.

Nisma kombëtare “*Cashless Albania 2030*” synon reduktimin progresiv të përdorimit të parasë fizike dhe nxitjen e përdorimit të instrumenteve elektronike të pagesave në të gjithë ekonominë. Kjo nismë përbën një nga shtyllat kryesore të modernizimit të sistemit financiar në vend, duke promovuar digjitalizimin e transaksioneve, rritjen e efikasitetit të pagesave dhe reduktimin e kostove që lidhen me përdorimin e *cash*-it.

Në këtë kuadër, nisma kontribuon në krijimin e një mjedisi rregullator të përshtatshëm për zhvillimin e shërbimeve moderne të pagesave, duke lehtësuar hyrjen e aktorëve të rinj në treg, si dhe duke përmirësuar ndërveprimin ndërmjet institucioneve financiare dhe atyre teknologjike. Përmes përafrimit me standardet evropiane dhe përfshirjes së koncepteve si pagesat e menjëhershme dhe shërbimet digjitale, ndërhyrja ligjore mbështet drejtpërdrejt objektivat e kësaj nisme për zgjerimin e përdorimit të pagesave elektronike nga qytetarët dhe bizneset.

Njëkohësisht, nisma “*Cashless Albania 2030*” synon edhe formalizimin e mëtejshëm të ekonomisë, rritjen e transparencës së transaksioneve dhe përmirësimin e mbledhjes së të ardhurave fiskale. Në këtë kontekst, një kuadër ligjor i përditësuar dhe i harmonizuar me praktikën evropiane është thelbësor për të garantuar që zhvillimi i pagesave digjitale të jetë i sigurt, i qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës, duke forcuar besimin e publikut në sistemin financiar dhe duke mbështetur zhvillimin ekonomik afatgjatë.

- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Në kuadër të zhvillimit të sektorit të shërbimeve të pagesave dhe të parasë elektronike, ndër vite është realizuar një sërë reformash dhe iniciativash në nivel ligjor, rregullator dhe institucional, të cilat kanë synuar modernizimin e sistemit financiar dhe përafrimin e tij gradual me standardet e Bashkimit Evropian. Konkretisht, është miratuar dhe zbatuar ligji nr. 55/2020 “Për shërbimet e pagesave”, i cili përbën bazën kryesore për rregullimin e këtij sektori dhe ka përafruar legjislacionin shqiptar me Direktivën PSD2, duke mundësuar zhvillimin e aktorëve të rinj në treg dhe zgjerimin e shërbimeve digjitale të pagesave.

Paralelisht, Banka e Shqipërisë ka ndërmarrë një rol aktiv në zhvillimin dhe përmirësimin e kuadrit rregullator dhe mbikëqyrës, si dhe në modernizimin e infrastrukturës së pagesave në vend. Janë ndërmarrë iniciativa për rritjen e efikasitetit të sistemeve të pagesave, zgjerimin e përdorimit të instrumenteve elektronike dhe forcimin e sigurisë së transaksioneve, duke përfshirë zhvillimin e sistemeve të pagesave me vlerë të madhe dhe me vlerë të vogël, si dhe përmirësimin e procedurave të mbikëqyrjes.

Gjithashtu, janë realizuar hapa të rëndësishëm në drejtim të digjitalizimit të shërbimeve financiare dhe nxitjes së përdorimit të pagesave elektronike, në përputhje me nismat kombëtare si “*Cashless Albania 2030*”. Këto përpjekje kanë synuar reduktimin e përdorimit të parasë fizike, përmirësimin e aksesit në shërbime financiare dhe rritjen e transparencës në ekonomi.

Gjithashtu Shqipëria është bërë pjesë e Zonës Unike të Pagesave në Euro (SEPA) që nga viti 2024, duke u integruar në një sistem evropian të standardizuar për realizimin e pagesave në euro. Ky anëtarësim mundëson që transfertat ndërkufitare të trajtohen sipas rregullave dhe standardeve të njëjta me ato të Bashkimit Evropian, duke reduktuar ndjeshëm kostot, kohën e ekzekutimit dhe kompleksitetin e pagesave ndërkombëtare. Në këtë mënyrë, SEPA përbën një hap të rëndësishëm drejt modernizimit të sistemit financiar dhe nxitjes së përdorimit të

pagesave elektronike, duke kontribuar drejtpërdrejt në procesin e digjitalizimit dhe në objektivat për uljen e përdorimit të parasë fizike në ekonomi.

Shqipëria është e angazhuar në disa nisma dhe projekte rajonale dhe evropiane për integrimin dhe modernizimin e sistemeve të pagesave, të cilat synojnë harmonizimin teknik dhe rregullator me standardet e Bashkimit Evropian. Ndër më kryesoret përfshihen iniciativat e mbështetura nga Banka Botërore dhe Banka e Italisë për zhvillimin e sistemeve të pagesave të menjëhershme në Ballkanin Perëndimor, përmes ndërtimit të infrastrukturës së përbashkët të pagesave në kohë reale, të bazuar në standarde evropiane si sistemi TIPS, duke mundësuar kryerjen e transfertave 24/7, në mënyrë të menjëhershme dhe me kosto të ulët, si dhe projektet e lidhura me SEPA për integrimin e mëtejshëm të tregjeve financiare rajonale në hapësirën evropiane të pagesave. Kjo nismë përbën një element kyç në procesin e digjitalizimit të pagesave dhe kontribuon drejtpërdrejt në reduktimin e përdorimit të parasë fizike dhe zhvillimin e një ekonomie më “cashless”. Gjithashtu, Shqipëria merr pjesë në iniciativat e Këshillit të Pagesave të Vetëm Evropian dhe në programe të Bashkimit Evropian për ndërveprueshmërinë e sistemeve të pagesave dhe standardizimin e proceseve teknike e operacionale, me qëllim sigurimin e një infrastrukture të unifikuar, të sigurt dhe efikase të pagesave në rajon.

Në të njëjtën kohë, është zhvilluar një proces i vazhdueshëm vlerësimi për nivelin e përafrimit me *acquis* të Bashkimit Evropian, duke identifikuar nevojat për përditësimin e kuadrit ligjor në funksion të përfshirjes së zhvillimeve më të fundit në fushën e pagesave, si pagesat e menjëhershme, qëndrueshmëria operacionale digjitale dhe zgjerimi i tregut ndërkufitar. Këto ndërhyrje të ndërmarra ndër vite kanë krijuar bazën mbi të cilën mbështetet nisma aktuale ligjore.

## **Objektivi i politikës**

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

Objektivat e politikës lidhen drejtpërdrejt me përafrimin e mëtejshëm të legjislationit shqiptar me legjislationin e Bashkimit Evropian. Këto objektiva synojnë rregullimin e mëtejshëm të shërbimeve të pagesave dhe të parasë elektronike në Republikën e Shqipërisë, duke krijuar një bazë të qëndrueshme normative për zhvillimin e tregut të shërbimeve të pagesave dhe të parasë elektronike, forcimin e stabilitetit financiar dhe përmbushjen e angazhimeve të Shqipërisë në kuadër të procesit të integritit evropian. Në këtë kuadër, objektivat e politikës janë formuluar në mënyrë që të jenë specifike, të matshëm, të arritshëm, realistë dhe të realizueshëm në kohë, duke kontribuar në përmirësimin e shërbimeve të pagesave në tregun vendas dhe mbikëqyrjen rigoroze të subjekteve që i ofrojnë këto shërbime në Republikën e Shqipërisë.

Përmes projektligjit të propozuar, synohet arritja e objektivave të mëposhtme:

1. Harmonizimi i plotë i legjislationit shqiptar me atë të Bashkimit Evropian në fushën e shërbimeve të pagesave dhe parasë elektronike, në kuadër të procesit të integritit evropian,;

2. Plotësimi i kuadrit ligjor ekzistues në përputhje me Direktivën (BE) 2015/2366 (PSD2) dhe Direktivën (KE) 2009/110 (EMD2), duke përfshirë edhe ndryshimet dhe zhvillimet më të fundit të këtyre direktivave, veçanërisht për PSD2 në lidhje me qëndrueshmërinë operacionale digjitale dhe pagesat e menjëhershme (*instant payments*);
3. Rritja e sigurisë juridike dhe qartësisë rregullatore për institucionet e parasë elektronike dhe emetimin e parasë elektronike.
4. Garantimi i njohjes së ndërsjellë të licencave (*passporting*), që mundëson ofrimin e shërbimeve ndërkufitare pas anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.
5. Rregullimi i qartë i marrëdhënieve, bashkëpunimit dhe ndarjes së përgjegjësisë ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe autoriteteve homologe mbikëqyrëse të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, pas anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian;
6. Përcaktimi i rregullave të detajuara për aktivitetin ndërkufitar pas anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, përfshirë hapjen e degëve nga institucionet shqiptare në vende të treta dhe nga institucionet e huaja në Shqipëri;
7. Rritja e transparencës në tregun e shërbimeve të pagesave dhe përmirësimi i informimit të përdoruesve mbi kushtet, tarifat dhe të drejtat e tyre;
8. Përcaktimi i kërkesave për tarifat e shkëmbimit në transaksionet me kartë, në përputhje me aktin përkatës të BE-së (Rregulloren (BE) 2015/751), me qëllim uljen e kostove të këtyre transaksioneve.
9. Përcaktimi i kushteve për pjesëmarrjen e institucioneve të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike në sistemet e pagesave me finalitet shlyerjeje.
10. Garantimi i stabilitetit dhe integritetit të sistemeve të pagesave përmes rregullave të pjesëmarrjes së institucioneve të pagesave dhe të parasë elektronike.
11. Qartësimi dhe forcimi i të drejtave dhe detyrimeve të përdoruesve dhe ofruesve të shërbimeve të pagesave, duke reflektuar praktikatat më të mira evropiane.

## **Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara**

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.*

Në kuadër të procesit të hartimit të projektligjit për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 55/2020 “Për shërbimet e pagesave”, janë shqyrtuar disa opsione politike dhe rregullatore me qëllim adresimin e problematikave të identifikuar në kuadrin aktual ligjor dhe përafrimin e tij me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

**Opsioni 0: Status quo (moskryerja e ndryshimeve duke pritur që situata të vetërregullohet)**

Ky opsion konsiston në ruajtjen e kuadrit ligjor aktual pa ndërmarrë asnjë ndryshim. Në këtë rast, kuadri ligjor për shërbimet e pagesave do të vazhdonte të funksiononte mbi bazën e dispozitave aktuale të ligjit dhe akteve nënligjore në fuqi.

Ky opsion nuk është i përshtatshëm për t'u zbatuar, për arsye se megjithëse ligji aktual krijon një bazë të rëndësishme për rregullimin e tregut të shërbimeve të pagesave, ai nuk parashikon një harmonizim të plotë me legjislacionin e BE-së në këtë fushë, duke shfaqur mangësi në lidhje me përafrimin e dispozitave të direktivës PSD2 të cilat rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet shteteve anëtare, për bashkëpunimin ndërkufitar, njohjen reciproke të licencave si edhe lidhur me detyrimet për shkëmbimin e informacionit ndërmjet autoriteteve përgjegjëse. Këto dispozita synojnë të sigurojnë zbatimin uniform të legjislacionit dhe funksionimin e një tregu të integruar të shërbimeve të pagesave në Bashkimin Evropian. Për më tepër edhe pse ky opsion nuk paraqet kosto të shtuar në burime, përsëri nuk është i përshtatshëm, pasi nuk mund të arrihet përputhshmëria e plotë me direktivën PSD2 si pjesë e Kapitullit 4 “Lëvizja e lirë e kapitalit”.

Si rrjedhojë, ruajtja e status quo-së do të sillte rrezikun e mbetjes pas në procesin e harmonizimit me *acquis* të Bashkimit Evropian dhe do të kufizonte përmirësimin e kuadrit të shërbimeve të pagesave.

**Opsioni 1 (jorregullator)** - nënkupton marrjen e masave jorregullatore si kryerja e fushatave ndërgjegjësuese dhe forcimi i praktikave mbikëqyrëse. Ky opsion mbështetet në rritjen e ndërgjegjësimit përmes fushatave informuese, trajnimeve dhe aktiviteteve edukative të institucioneve të pagesave dhe të parasë elektronike dhe klientëve të tyre, pa ndryshime në kuadrin ligjor. Megjithëse kontribuon në përmirësimin e njohurive të subjekteve dhe përdoruesve të shërbimeve të pagesave dhe mund të ketë kosto më të ulëta se opsione të tjera, ai nuk siguron zgjidhje afatgjatë për mangësitë e identifikuara në kuadrin ligjor, nuk mundëson plotësimin e angazhimeve në kuadër të integritimit evropian, si dhe nuk mundëson arritjen e objektivave për unifikimin e kërkesave në fushën e pagesave dhe parasë elektronike me ato të tregut evropian.

### **Opsioni 2: Ndryshimi i ligjit ekzistues përmes shtesave dhe ndryshimeve të targetuara (opsioni rregullator – opsioni i preferuar)**

Ky opsion konsiston në ndërmarrjen e ndryshimeve të nevojshme në ligjin ekzistues nr. 55/2020 përmes shtesave dhe përmirësimeve të disa dispozitave të tij, me qëllim përafrimin e plotë me direktivën evropiane të shërbimeve të pagesave PSD2 dhe dispozitat e direktivës EMD2, shtimin e kërkesave të transparencës dhe sigurisë, ofrimit të shërbimeve të pagesave brenda afateve sa më të shkurtra kohore dhe me kosto më të ulëta, si për pagesat brenda vendit, ashtu edhe me vende të BE-së, parashikimin në akt ligjor të kërkesave për licencimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve të parasë elektronike apo të emetuesve të saj, rregullimin në tërësi të marrëdhënieve të Bankës së Shqipërisë si autoritet përgjegjës për licencimin e subjekteve që ofrojnë shërbime pagesash dhe si autoritet i vendit pritës kur ky shërbim do të kryhet nga ofrues të autorizuar në Bashkimin Evropian, etj.

Ky opsion është konsideruar si më i përshtatshmi, pasi ofron fleksibilitet dhe ndërhyrje relativisht të shpejtë dhe mundëson realizimin e objektivave të reformës pa qenë e nevojshme të hartohet një ligj i ri në tërësi, por do të mundësohet kryerja e disa saktësimeve dhe shtesave në dispozitat aktuale të këtij ligji. Përmes këtij opsioni do të bëhen ndryshime të targetuara dhe

të balancuara në dispozitat ekzistuese të ligjit, duke ruajtur strukturën e tij bazë dhe duke shmangur kosto të panevojshme institucionale dhe administrative. Duke qenë se ligji në fuqi “Për shërbimet e pagesave” i miratuar në vitin 2020, parashikon në një shkallë të lartë, kërkesa të Direktivës PSD2, shihet si më i arsyeshëm ndryshimi i ligjit ekzistues duke shtuar dispozita që nuk ishin relevante në vitin 2020 (kur u miratua ligji), ose që janë shtuar pas miratimit të tij, sesa të miratohet një ligj i ri.

**Opsioni 3 (rregullator):** – Miratimi i një ligji të ri në fushën e shërbimeve të pagesave. Hartimi i një ligji të ri do të bëhej mbi bazën e tekstit të konsoliduar të Direktivave PSD2, EMD2 dhe ndryshimeve të tyre, duke shmangur çdo mbivendosje apo paqartësi që vjen nga ndryshimet e ligjit ekzistues, duke lejuar edhe riorganizimin e plotë të kapitujve dhe dispozitave, duke bashkuar në një instrument të vetëm rregullimin e shërbimeve të pagesave dhe të institucioneve të parasë elektronike, pa nevojën e shtimit të neneve të ndërmjetëm në ligjin ekzistues. Miratimi i një akti të ri ligjor gjithëpërfshirës do të jepte edhe një mesazh të qartë ndaj institucioneve të BE-së lidhur me vullnetin e Shqipërisë për harmonizim të plotë dhe të qëndrueshëm.

Por vlerësohet se ky opsion nuk është i përshtatshëm, për arsye se ndryshimet që synohen të ndërmerren për zgjidhjen e mangësive të evidentuara, nuk ndikojnë në thelbin e ligjit ekzistues dhe për më tepër hartimi i një ligji të ri paraqet kosto më të madhe në drejtim të burimeve materiale dhe njerëzore krahasuar me opsionet e tjera. Nëpërmjet ndryshimeve të ligjit ekzistues synohet të rregullojnë dispozitat e munguara të cilat lidhen me marrëdhëniet ndërkufitare dhe vendosjen e rregullave të detajuara për aktivitetin ndërkufitar ose me aktivitetin e institucioneve të parasë elektronike, të cilat nuk ndikojnë në thelbin dhe strukturën e ligjit ekzistues. Për më tepër hartimi i një ligji të ri paraqet kosto më të madhe në drejtim të burimeve materiale dhe njerëzore krahasuar me opsionet e tjera. Hartimi i një ligji të ri kërkon edhe afate të gjata konsultimi publik dhe ndërinstitutional, gjë që do të vononte implementimin e tij dhe mund të ndikonte në mosrespektimin e afateve të harmonizimit me *acquis* të BE-së dhe piketat mbyllëse të Kapitullit 4.

## **Përzgjedhja e opsioneve të shqyrtuara**

Opsionet e mësipërme janë përzgjedhur duke marrë në konsideratë nevojën për të adresuar problematikat e identifikuar në kuadrin aktual ligjor, kërkesat që rrjedhin nga procesi i integritimit evropian dhe zhvillimet e fundit në legjislacionin e Bashkimit Evropian në fushën e shërbimeve të pagesave, si dhe nevoja e rregullimit në formë ligjore të aktivitetit të institucioneve të parasë elektronike.

Pas analizimit të përfitimeve dhe kostove të secilit opsion, është vlerësuar se opsioni i ndryshimit të ligjit ekzistues përmes shtesave dhe ndryshimeve të targetuara (Opsioni 2) përfaqëson alternativën më të përshtatshme dhe më efektive për arritjen e objektivave të synuar. Ky opsion mundëson një përafrim të mëtijshëm me legjislacionin e Bashkimit Evropian, duke ruajtur stabilitetin e kuadrit ligjor ekzistues dhe duke minimizuar kostot administrative dhe institucionale.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni se kush preket.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*

Në kuadër të analizës së projektligjit për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 55/2020 “Për shërbimet e pagesave”, është kryer një vlerësim i ndikimeve që mund të sjellë opsioni i preferuar (ndryshimi i ligjit ekzistues përmes shtesave dhe ndryshimeve të targetuara). Kjo analizë merr në konsideratë grupet kryesore të interesit që preken nga kjo nismë dhe llojet e ndikimeve që do të kenë mbi secilin prej tyre.

Në tërësi, projektligji pritet të kontribuojë në krijimin e një sistemi të përafruar plotësisht me kuadrin evropian të shërbimeve të pagesave, duke mbështetur kështu edhe qasjen e qeverisë shqiptare për të ulur pagesat me *cash* dhe përdorimin e pagesave elektronike, të kanalizuar nëpërmjet ofruesve të shërbimeve të pagesave të licencuar nga Banka e Shqipërisë dhe, me anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian edhe nëpërmjet ofruesve të shteteve të tjera anëtare që mund të përdorin të drejtën e ofrimit direkt të shërbimeve në Shqipëri, pa qenë nevoja e licencimit nga Banka e Shqipërisë. Ushtrimi i kësaj të drejte do të ndikojë edhe te ofruesit e shërbimeve të pagesave të licencuar nga Banka e Shqipërisë, të cilët kur Shqipëria të anëtarësohet në BE, do të kenë të drejtën e ofrimit të shërbimeve të tyre, edhe në vende të tjera të Bashkimit Evropian.

Zbatimi i projektligjit pritet të sjellë efekte pozitive në përmirësimin e funksionimit të tregut të pagesave, duke nxitur inovacionin dhe hyrjen e aktorëve të rinj në treg, si dhe duke rritur konkurrencën ndërmjet ofruesve të shërbimeve. Njëkohësisht, ai synon të forcojë mbrojtjen e konsumatorëve dhe besimin e publikut në sistemin financiar, nëpërmjet rregullave më të qarta dhe standardeve më të larta të transparencës dhe sigurisë. Në një perspektivë më të gjerë, projektligji krijon kushtet e nevojshme për integrimin gradual të tregut shqiptar të pagesave me tregun evropian, duke kontribuar në rritjen e besimit të investitorëve dhe zhvillimin e mëtejshëm të sektorit financiar në vend.

### **Ndikimet sipas dimensioneve kryesore**

Ndikimet e projektligjit mund të grupohen në tre dimensione kryesore, të cilat pasqyrojnë natyrën e ndërhyrjes dhe efektet e saj në ekonomi dhe shoqëri.

Në aspektin ekonomik, masa e propozuar pritet të sjellë rritje të konkurrencës në tregun e shërbimeve të pagesave, përmes lehtësimit të hyrjes së aktorëve të rinj dhe rritjes së mundësive për inovacion. Gjithashtu, pritet ulje e kostove të transaksioneve për përdoruesit fundorë, nxitje e investimeve në infrastrukturë teknologjike dhe përmirësim i eficiencës së ofrimit të shërbimeve financiare. Këto ndryshime kontribuojnë në modernizimin e tregut dhe në rritjen e produktivitetit ekonomik në tërësi.

Në aspektin social, projektligji pritet të ndikojë pozitivisht në rritjen e përfshirjes financiare të qytetarëve dhe bizneseve, duke lehtësuar aksesin në shërbimet digjitale të pagesave. Po ashtu, forcohet mbrojtja e konsumatorëve përmes rritjes së transparencës së tarifave, kushteve të përdorimit dhe mekanizmave të ankimit, si dhe përmes rritjes së sigurisë në përdorimin e instrumenteve elektronike të pagesave.

Në aspektin institucional, reforma sjell forcim të rolit mbikëqyrës dhe rregullator të Bankës së Shqipërisë, rritje të bashkëpunimit me autoritetet e huaja në kuadër të mbikëqyrjes ndërkufitare dhe përafrim më të madh të praktikave kombëtare me standardet evropiane. Këto ndryshime kontribuojnë në rritjen e qëndrueshmërisë dhe integritetit të sistemit financiar.

### **Grupet kryesore të prekura**

Nga zbatimi i projektligjit pritet të preken drejtpërdrejt ose tërthorazi disa grupe kryesore aktorësh që veprojnë në fushën e shërbimeve të pagesave në Republikën e Shqipërisë. Këto grupe përfshijnë:

- Subjektet e licencuara nga Banka e Shqipërisë para hyrjes në fuqi të ndryshimeve të ligjit (*bankat, institucionet e pagesave, institucionet e parasë elektronike*);
- Subjektet që do të licencohen pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve ligjore;
- Kur Shqipëria të jetë shtet anëtar në Bashkimin Evropian, subjekte që do të ofrojnë shërbime pagesash apo emetimin e parasë elektronike në kuadër të konceptit “*passporting*”;
- Klientët e ofruesve të shërbimeve të pagesave apo emetuesve të parasë elektronike (*veçanërisht konsumatorët dhe mikrondërmarrjet*);
- Sektori publik/qeveria.

### **Grupet e prekura drejtpërdrejt:**

- Institucionet e pagesave të licencuara nga Banka e Shqipërisë dhe degë të institucioneve të pagesave, me zyrë qendrore në një vend të tretë, që ofrojnë shërbime pagesash në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- Bankat (institucionet e kreditit) e licencuara nga Banka e Shqipërisë dhe degë të institucioneve të kreditit, me zyrë qendrore në një vend të tretë, që ushtrojnë veprimtari në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- Institucionet e parasë elektronike të licencuara nga Banka e Shqipërisë dhe degë të institucioneve të parasë elektronike, me zyrë qendrore në një vend të tretë, që ofrojnë shërbime pagesash në territorin e Republikës së Shqipërisë, për aq sa shërbimet e pagesave të ofruara prej tyre janë të lidhura me emetimin e parasë elektronike;
- Banka e Shqipërisë ose autoritete të tjera publike.

Gjithashtu kur Shqipëria të jetë shtet anëtar në Bashkimin Evropian, ky ligj do të ketë impakt edhe mbi këto subjekte:

- Institucionet e kreditit me zyrë qendrore në një shtet tjetër anëtar, të licencuar nga autoritetet përgjegjëse të shtetit anëtar të origjinës, duke përfshirë edhe degët e tyre të krijuara në Republikën e Shqipërisë;
- Institucionet e parasë elektronike me zyrë qendrore në një shtet tjetër anëtar, të licencuar nga autoritetet përgjegjëse të shtetit anëtar të origjinës, duke përfshirë edhe degët e tyre të krijuara në Republikën e Shqipërisë, për aq sa shërbimet e pagesave të ofruara nga këto degë janë të lidhura me emetimin e parasë elektronike;
- Institucionet e pagesave me zyrë qendrore në një shtet tjetër anëtar, të licencuar nga autoritetet përgjegjëse të shtetit anëtar të origjinës, duke përfshirë edhe degët e tyre të krijuara në Republikën e Shqipërisë.

### **Grupet e prekura jo drejtpërdrejt:**

- Konsumatorët dhe të gjithë përdoruesit e shërbimeve të pagesave dhe mbajtësit e parasë elektronike;
- Bizneset;
- Sektori publik/qeveria.

## Ndikimet mbi grupet e prekura

### 1. Subjektet e licencuara nga Banka e Shqipërisë para hyrjes në fuqi të ndryshimeve të ligjit

- **Ndikime të drejtpërdrejta:**
  - Krijimi i kushteve ligjore për ushtrimin e aktivitetit në tregun evropian nëpërmjet mekanizmit të njohjes së ndërsjellë të licencave (*passporting*) pas anëtarësimit në BE
  - Mundësi për zgjerimin e aktivitetit dhe hapjen e degëve në juridiksione të tjera, sipas kuadrit të ri ligjor.
  - Krijimi i një ambienti më konkurrues;
  - Përqasje më efektive e ofrimit të shërbimeve, si rrjedhojë e digjitalizimit dhe ofrimit të pagesave të menjëhershme;
  - Kosto për zhvillime infrastrukturore për t'u përshtatur me zhvillimet e reja si edhe përshtatje rregullative dhe proceduriale për të zbatuar dispozitat ligjore;
  - Nevoja për zhvillimin e programeve të reja të trajnimit dhe certifikimit për punonjësit për sigurimin e përputhshmërisë dhe të kuptuarit të kërkesave ligjore e rregullative;
  - Përmirësim i aksesit në sistemet dhe infrastrukturat e pagesave;
  - Mundësi për zhvillimin dhe ofrimin e produkteve dhe shërbimeve të reja të pagesave;
  - Rritje e besimit të klientëve si rezultat i forcimit të standardeve të sigurisë dhe mbrojtjes së përdoruesve.
  
- **Ndikime jo të drejtpërdrejta:**
  - rritje e besueshmërisë së klientëve;
  - zgjerim i mundësive për rritjen e numrit të klientëve.

Projektligji forcon kërkesat për mbrojtjen e fondeve të klientëve, kërkon procedura shtesë raportimi, monitorimi dhe bashkëpunimi me autoritetet mbikëqyrëse dhe përcakton kërkesa për tarifën e shkëmbimit në transaksionet me kartë, me qëllim uljen e kostove të këtyre transaksioneve.

Këto ndryshime mund të krijojnë:

- kosto përputhshmërie;

- kosto organizative;
- kosto trajnimi;
- kosto procedurale.

Megjithatë, në rastin konkret të këtij projektligji, shumë nga ndryshimet janë të natyrës institucionale, licencuese dhe rregullatore, ndërsa elementët që mund të sjellin ndikime financiare konkrete (p.sh. tarifatat e shkëmbimit, kërkesat teknike, procedurat e reja) do të përcaktohen me akte nënligjore ose varen nga mënyra e zbatimit të tyre në praktikë. Për këtë arsye, mungon baza e nevojshme për një vlerësim sasior të besueshëm të kostove dhe përfitimeve në këtë fazë. Këto efekte mund të vlerësohen gjatë hartimit të akteve nënligjore për tarifatat e shkëmbimit, për pagesat e menjëhershme, apo për kuadrin e qëndrueshmërisë operacionale digjitale.

Subjektet e ligjit që operojnë aktualisht në treg, pritet të kenë kosto dhe investime shtesë për zhvillimet teknologjike, për t'i përshtatur me kërkesat e administrimit të rrezikut të TIK, por edhe me nevoja për personel të kualifikuar. Gjithashtu, institucionet e pagesave dhe të parasë elektronike që do të dëshirojnë të marrin pjesë në sistemet e pagesave me finalitet shlyerje, duhet të sigurojnë plotësimin e kërkesave të reja, që do të shoqërohen me kosto për zhvillimet e sistemeve, rritjen e elementëve të sigurisë, trajnimin e personelit, etj. Ofrimi i pagesave të menjëhershme apo caktimi i taveve për tarifatat e shkëmbimit, pritet të kenë efekte te subjektet në drejtim të përshtatjes së tyre për të qenë sa më konkurrentë.

## 2. Subjektet që do të licencohen pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve ligjore

- **Ndikime të drejtpërdrejta:**

- Mundësi për përfshirje në tregun e shërbimeve të pagesave dhe parasë elektronike, me standarde të krahasueshme me ato të aplikuara në BE;
- Mundësi për zgjerimin e aktivitetit dhe ofrimin e shërbimeve ndërkufitare në përputhje me kuadrin evropian, pas anëtarësimit të Shqipërisë në BE.;
- Mundësi për zhvillimin e modeleve të reja të biznesit dhe ofrimin e shërbimeve inovative të pagesave.
- Mundësi për të përfituar nga infrastruktura moderne e pagesave, përfshirë pagesat e menjëhershme.
- Rritje e besimit të klientëve dhe investitorëve për shkak të funksionimit në një kuadër rregullator të harmonizuar me standardet evropiane.
- Qartësi më e madhe ligjore dhe rregullatore në lidhje me kushtet e licencimit, mbikëqyrjes dhe ushtrimit të veprimtarisë.
- Mundësi për të hapur degë në Republikën e Shqipërisë, nga institucione të licencuara në shtete të tjera;
- Kontribut në një ambient të balancuar për rritjen e konkurrencës;
- Nevoja për krijimin e strukturave organizative, sistemeve teknologjike dhe procedurave të brendshme në përputhje me kërkesat e reja ligjore dhe rregullatore ;

- Barrierë më e lartë hyrjeje për shkak të kërkesave të avancuara teknologjike, organizative dhe të sigurisë;
  - Kosto për përmbushjen e kërkesave të licencimit dhe të mbikëqyrjes;
  - Nevoja për rekrutimin dhe trajnimin e personelit të specializuar;
  - Kosto të vazhdueshme për përputhshmërinë rregullatore, raportimin dhe auditimin;
  - Nevojë për investime fillestare në infrastrukturë, sisteme IT dhe siguri kibernetike, që në fazën e krijimit.
- **Ndikime jo të drejtpërdrejta:**
    - Rritja e gamës së shërbimeve dhe produkteve të ofruara;
    - Ekspozim ndaj një niveli më të lartë konkurrence nga subjektet ekzistuese dhe operatorët e tjerë që veprojnë në treg;
    - Promovimi dhe ndërgjegjësimi i përdoruesve të shërbimeve të pagesave apo mbajtësve të parasë elektronike, nëpërmjet rritjes së edukimit financiar, kryesisht mbi përdorimin e instrumenteve elektronike të pagesave.

### **3. Kur Shqipëria të jetë shtet anëtar në Bashkimin Evropian, subjekte që do të ofrojnë shërbime pagesash apo emetimin e parasë elektronike në kuadër të mekanizmit “*passporting*”;**

- **Ndikime të drejtpërdrejta:**
  - Mundësi për përfshirje në tregun e shërbimeve të pagesave dhe parasë elektronike, në BE, e subjekteve të licencuara nga Banka e Shqipërisë;
  - Mundësi për ofrimin e shërbimeve të pagesave dhe parasë elektronike në territorin e Republikës së Shqipërisë, pa qenë nevoja e licencimit nga Banka e Shqipërisë;
  - Kontribut në rritjen e konkurrencës;
  - Angazhim për arritjen e standardeve për të konkurruar me aktorët që operojnë në tregun e përbashkët evropian;
  - Nevoja për përshtatjen me kërkesat ligjore e nënligjore të vendit përkatës;
- **Ndikime jo të drejtpërdrejta:**
  - Rritja e gamës së shërbimeve dhe produkteve të ofruara dhe presione mbi konkurrueshmërinë e subjekteve që operojnë në treg.

### **4. Banka e Shqipërisë si autoritet mbikëqyrës**

Nga shqyrtimi i projektligjit nuk rezulton krijimi i një institucioni të ri, fondeve buxhetore, subvencioneve apo detyrimeve financiare direkte për buxhetin e shtetit.

Megjithatë, Bankës së Shqipërisë i ngarkohen funksione shtesë në:

- licencim dhe mbikëqyrje;
- bashkëpunim me autoritetet e shteteve anëtare;
- shkëmbim informacioni;
- monitorim të aktiviteteve ndërkufitare;
- zbatim të kërkesave të reja për tarifatat e shkëmbimit dhe pagesat.

Projektligji mund të sjellë rritje të ngarkesës administrative dhe operacionale për Bankën e Shqipërisë, por nuk identifikohen kosto buxhetore të drejtpërdrejta dhe të matshme në fazën aktuale.

## **5. Klientët e ofruesve të shërbimeve të pagesave apo emetuesve të parasë elektronike (veçanërisht konsumatorët dhe mikrondërmarrjet)**

### **• Ndikim i drejtpërdrejtë**

- Zgjerimi i gamës së shërbimeve të pagesave të ofruara;
- Përftimi i shërbimeve të pagesave në një ambient më të sigurt (më pak incidente dhe ndërprerje) dhe me standarde;
- Mbrojtje më e mirë ndaj mashtrimeve dhe sulmeve kibernetike;
- Besim më i madh në pagesat elektronike dhe *fintech*;
- Përftimi i shërbimeve të pagesave me kosto më të ulëta;
- Mundësi për kryerjen e pagesave dhe transfertave në kohë reale (*instant payments*);
- Akses më i lehtë dhe më i shpejtë në shërbimet financiare dhe të pagesave;
- Përmirësim i transparencës së informacionit mbi tarifatat, kushtet dhe të drejtat e përdoruesve;
- Rritje e mbrojtjes së të drejtave të përdoruesve në rast transaksionesh të paautorizuara ose mosmarrëveshjesh;
- Përmirësim i cilësisë së shërbimeve si rezultat i rritjes së konkurrencës ndërmjet ofruesve;
- Mundësi më të mëdha për përdorimin e instrumenteve digjitale të pagesave nga mikrondërmarrjet.

### **• Ndikim jo i drejtpërdrejtë**

- Përfshirje më e lartë financiare e klientëve që përdorin shërbimet e pagesave apo instrumentet e parasë elektronike;
- Nevoja për përshtatje me instrumente dhe procese të reja digjitale;
- Varësi më e madhe nga infrastruktura teknologjike dhe interneti.

Projektligji pritet të ketë potencialisht ndikime pozitive ekonomike mbi konsumatorët dhe mikrondërmarrjet. Projektligji parashikon ndër të tjera rregullimin e tarifave të shkëmbimit për

pagesat me kartë (që do të detajohen më tej me akte nënligjore) si dhe zhvillimin e pagesave më efikase dhe rritjen e konkurrencës në treg.

Këto ndryshime pritet të sjellin:

- ulje të kostove të pagesave;
  - ulje të kostove për tregtarët;
  - përfitime për konsumatorët.
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
    - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
    - *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
    - *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni).*
    - *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.*

### Lidhur me ndikimet e drejtpërdrejta

Në tërësi, ndryshimet e propozuara në ligjin për shërbimet e pagesave pritet të kenë një ndikim pozitiv në funksionimin e tregut të pagesave dhe emetimit të parasë elektronike në Shqipëri. Ndikimet kryesore lidhen me rritjen e transparencës, konkurrueshmërisë, sigurisë në ofrimin e këtyre shërbimeve dhe produkteve. Ndërkohë, kostot e zbatimit të këtyre ndryshimeve pritet të jenë kryesisht të lidhura me nevojën për investime në sisteme të përditësuara, më të sigurt dhe me standarde, në trajnime dhe përditësim të praktikave të ndjekura nga subjektet.

Hyrja në fuqi e ndryshimeve ligjore, pritet të ndikojë në rritjen e konkurrencës midis subjekteve që tashmë operojnë në treg dhe institucioneve të reja që mund të hyjnë në këtë treg, përfshirë edhe subjektet që do të përdorin të drejtën e ofrimit direkt të shërbimeve “*passporting*”, pa qenë nevoja e një licencimi të ri kur Shqipëria të anëtarësohet në Bashkimin Evropian. Rritja e kërkesave për qëndrueshmërisë operationale digjitale dhe administrimin e rrezikut të TIK, do të shoqërohet me kosto për subjektet, të cilët duhet të sigurojnë përputhshmërinë me standardet për sigurinë dhe qëndrueshmërinë operationale digjitale, por që në fund përmirësojnë stabilitetin e sistemit financiar dhe besimin e përdoruesve të shërbimeve të pagesave.

Rritja e kërkesave për sigurinë dhe transparencën e përdorimit të instrumenteve elektronike të pagesave, pritet të mundësojë edhe uljen e përdorimit të *cash*-it dhe instrumenteve të pagesave në formë letër nga aktorët ekonomikë, duke ndihmuar në rritjen e produktivitetit dhe efikasitetit të ekonomisë shqiptare.

### **Përmbledhje e ndikimeve neto**

Në vlerësim të përgjithshëm, zbatimi i Opsionit 2 rezulton të ketë një ndikim neto pozitiv në funksionimin e tregut të shërbimeve të pagesave dhe emetimit të parasë elektronike në Republikën e Shqipërisë. Ky vlerësim bazohet në balancimin midis përfitimeve që rrjedhin nga harmonizimi i kuadrit ligjor me standardet e Bashkimit Evropian, rritjes së konkurrencës në

treg, forcimit të sigurisë dhe transparencës së shërbimeve, si dhe përmirësimit të mbrojtjes së përdoruesve, kundrejt kostove të lidhura kryesisht me përshtatjen teknologjike, organizative dhe rregullatore të subjekteve të tregut.

Kostot e identifikuar vlerësohen kryesisht si afatshkurtra dhe të përqendruara në fazën e zbatimit, ndërsa përfitimet janë afatgjata, strukturore dhe të qëndrueshme, duke ndikuar në modernizimin e sistemit financiar dhe në rritjen e integritit të tij me tregun evropian. Për rrjedhojë, efekti i përgjithshëm i reformës vlerësohet pozitiv dhe në përputhje me objektivat strategjike të integritit evropian dhe zhvillimit të tregut financiar.

- *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
  - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
  - *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*

Ndikimet jo të drejtpërdrejta lidhen me efektet që politika ose masa e propozuar mund të ketë në mënyrë indirekte mbi grupet e prekura.

Siç u analizua edhe më lart, për subjektet që aktualisht operojnë në treg, përputhshmëria me ndryshimet ligjore do të ndikonte në rritjen e mundësive për shtimin e bazës së klientëve, nëpërmjet mundësisë për të hapur degë edhe në vende të tjera. gjithashtu, investimi në rritjen e elementëve të sigurisë dhe të transparencës ndaj klientëve, do të ndikonte në rritjen e besueshmërisë së tyre ndaj këtyre subjekteve dhe rritjen e nivelit të përdorimit të shërbimeve përkatëse.

Për subjektet që do të licencohen pas miratimit të ndryshimeve ligjore dhe për subjektet që do të ofrojnë shërbime pagesash apo emetimin e parasë elektronike në kuadër të konceptit “*passporting*”, këto ndryshime ligjore pritet të ndikojnë në rritjen e gamës së shërbimeve dhe produkteve të ofruara dhe të presionit mbi konkurrueshmërinë e subjekteve që operojnë në treg, por edhe në promovimin e shërbimeve të pagesave apo të parasë elektronike, nëpërmjet rritjes së edukimit financiar, kryesisht mbi përdorimin e instrumenteve elektronike të pagesave.

Për klientët, ndikimet jo të drejtpërdrejta përfshijnë përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara dhe përfshirje më e lartë financiare për përdorimin e shërbimeve të pagesave apo instrumenteve të parasë elektronike.

Nga analiza paraprake rezulton se masa e propozuar do të ndikojë pozitivisht në rritjen e konkurrencës në treg, pasi masat e propozuara synojnë përmirësimin e funksionimit të tregut dhe uljen e barrierave. Përmirësimi i kërkesave për sigurinë, transparencën dhe krijimi i një trajtimi të standardizuar të subjekteve të licencuara në Shqipëri me ato që janë licencuar në shtete të tjera të BE-së (kur Shqipëria të anëtarësohet në Bashkimin Evropian), pritet të krijojë mundësi më të barabarta për të gjitha subjektet ekonomike, duke shmangur trajtimin e pabarabartë dhe duke nxitur një mjedis më konkurrues.

- *Diskutoni kufizimin e analizës:*
  - *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe rreziqet, të cilave ato u nënshtrohen.*

## Supozime të analizës

Analiza e ndikimit është ndërtuar mbi disa supozime kryesore që lidhen me funksionimin e tregut dhe zbatimin e kuadrit të ri ligjor. Në veçanti, është supozuar se subjektet e tregut do të përshtaten në mënyrë graduale me kërkesat e reja ligjore dhe teknike, si dhe se autoritetet mbikëqyrëse do të kenë kapacitetet e nevojshme institucionale për të garantuar zbatimin efektiv të dispozitave të reja.

Një kufizim i rëndësishëm i kësaj analize lidhet me mungesën e të dhënave të detajuara mbi kostot konkrete të investimeve në teknologji, kostot e përputhshmërisë dhe sjelljen afatgjatë të tregut pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve ligjore. Për këtë arsye, nuk ka qenë e mundur ndërtimi i një modeli të plotë sasior të kostove dhe përfitimeve, duke e orientuar analizën kryesisht në vlerësim cilësor dhe krahasimin me praktikatat evropiane.

Gjithashtu, është supozuar se tregu do të reagojë në mënyrë të rregullt ndaj rritjes së konkurrencës dhe se institucionet publike dhe private do të zbatojnë kërkesat e reja në mënyrë të koordinuar dhe të qëndrueshme.

- *Tregoni sa të forta, të pavarura dhe të rëndësishme janë provat që mbështesin supozimet.*

Supozimet e përdorura në këtë analizë të ndikimit, mbështeten në studime të kryera më parë, por veçanërisht në praktikatat ekzistuese të zbatimit të legjislacionit për shërbimet e pagesave dhe parasë elektronike, si dhe në përvojën e Bankës së Shqipërisë për mbikëqyrjen dhe rregullimin e kësaj fushe. Gjithashtu, ato bazohen në nevojën për përafrimin e kuadrit ligjor në fuqi, me praktikatat dhe standardet më të mira të aplikuara në Bashkimin Evropian.

Megjithëse këto burime konsiderohen një bazë e përshtatshme për vlerësimin e ndikimeve, disa parashikime mbështeten në vlerësime cilësore dhe në gjykime profesionale, për shkak të mungesës së të dhënave të detajuara statistikore mbi kostot dhe përfitimet konkrete të pritshme.

- *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*

Zbatimi i ndryshimeve të propozuara mund të ndikohet nga disa rreziqe kryesore. Një prej tyre lidhet me vonesat në adoptimin e standardeve të reja teknologjike dhe rregullatore nga subjektet e tregut, veçanërisht nga ato më të vogla që mund të kenë kufizime financiare dhe organizative. Një rrezik tjetër lidhet me mungesën e kapaciteteve të mjaftueshme teknologjike dhe njerëzore për të përballuar kërkesat e reja të sigurisë dhe raportimit.

Gjithashtu, gjatë fazës së tranzicionit mund të shfaqen mospërputhje të përkohshme në treg, si pasojë e diferencave në nivelin e përgatitjes së subjekteve. Një faktor tjetër rreziku lidhet me varësinë e efektivitetit të plotë të reformës nga miratimi dhe zbatimi në kohë i akteve nënligjore, të cilat do të përcaktojnë detajet teknike dhe operacionale të disa prej kërkesave kryesore të ligjit.

- *Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:*

- *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
- *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
- *Paraqisni përlogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (shih aneksin 1/b për tabelën që mund të përdorni).*

Në kuadër të procesit të hartimit të projektligjit për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 55/2020 “Për shërbimet e pagesave”, janë shqyrtuar disa opsione politike dhe rregullatore me qëllim adresimin e problematikave të identifikuara në kuadrin aktual ligjor dhe përafrimin e tij me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

### **Opsioni 0: Status quo (mosndryshimi i kuadrit ligjor ekzistues)**

Ky opsion konsiston në ruajtjen e kuadrit ligjor aktual pa ndërmarrë ndryshime në ligjin nr. 55/2020. Në këtë rast, kuadri ligjor për shërbimet e pagesave do të vazhdonte të funksiononte mbi bazën e dispozitave aktuale të ligjit dhe akteve nënligjore në fuqi.

Ky opsion nuk është i përshtatshëm për t’u zbatuar, për arsye se megjithëse ligji aktual krijon një bazë të rëndësishme për rregullimin e tregut të shërbimeve të pagesave, ai nuk parashikon një harmonizim të plotë me legjislacionin e BE-së në këtë fushë, duke shfaqur mangësi në lidhje me përafrimin e dispozitave të direktivës PSD2 të cilat rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet shteteve anëtare, për bashkëpunimin ndërkuftar, njohjen reciproke të licencave si edhe lidhur me detyrimet për shkëmbimin e informacionit ndërmjet autoriteteve përgjegjëse. Këto dispozita synojnë të sigurojnë zbatimin uniform të legjislacionit dhe funksionimin e një tregu të integruar të shërbimeve të pagesave në Bashkimin Evropian. Për më tepër edhe pse ky opsion nuk paraqet kosto të shtuar në burime, përsëri nuk është i përshtatshëm, pasi nuk mund të arrihet përputhshmëria e plotë me direktivën PSD2 si pjesë e Kapitullit 4 “Lëvizja e lirë e kapitalit”.

Si rrjedhojë, ruajtja e status quo-së do të sillte rrezikun e mbetjes pas në procesin e harmonizimit me *acquis* të Bashkimit Evropian dhe do të kufizonte përmirësimin e kuadrit të shërbimeve të pagesave.

**Opsioni 1 (jorregullator)** - nënkupton marrjen e masave jorregullatore si kryerja e fushatave ndërgjegjësuese dhe forcimi i praktikave mbikëqyrëse. Ky opsion mbështetet në rritjen e ndërgjegjësimit përmes fushatave informuese, trajnimeve dhe aktiviteteve edukative të institucioneve të pagesave dhe të parasë elektronike dhe klientëve të tyre, pa ndryshime ligjore. Megjithëse kontribuon në përmirësimin e njohurive të publikut dhe subjekteve dhe mund të ketë kosto më të ulëta se opsione të tjera, ai nuk siguron zgjidhje afatgjatë për mangësitë e identifikuara në kuadrin ligjor, nuk mundëson plotësimin e angazhimeve në kuadër të integritit evropian, si dhe nuk mundëson arritjen e objektivave për unifikimin e kërkesave në fushën e pagesave dhe parasë elektronike me ato të tregut evropian.

## **Opsioni 2: Ndryshimi i ligjit ekzistues përmes shtesave dhe ndryshimeve të targetuara (opsioni rregullator – opsioni i preferuar)**

Ky opsion konsiston në ndërmarrjen e ndryshimeve të nevojshme në ligjin ekzistues nr. 55/2020 përmes shtesave dhe përmirësimeve të disa dispozitave të tij, me qëllim përafrimin e plotë me direktivën evropiane të shërbimeve të pagesave PSD2 dhe dispozitat e direktivës EMD2, shtimin e kërkesave të transparencës dhe sigurisë, ofrimit të shërbimeve të pagesave brenda afateve sa më të shkurtra kohore dhe me kosto më të ulëta, si për pagesat brenda vendit, ashtu edhe me vende të BE-së, parashikimin në akt ligjor të kërkesave për licencimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve të parasë elektronike apo të emetuesve të saj, rregullimin në tërësi të marrëdhënieve të Bankës së Shqipërisë si autoritet përgjegjës për licencimin e subjekteve që ofrojnë shërbime pagesash dhe si autoritet i vendit pritës kur ky shërbim do të kryhet nga ofrues të autorizuar në Bashkimin Evropian, etj.

Opsioni 2 vlerësohet si më i përshtatshmi për zgjidhjen e problematikave të identifikuara, pasi siguron një balancë optimale midis arritjes së objektivave rregullatore dhe minimizimit të kostove të tranzicionit. Ky opsion është më proporcional, pasi ndërhyrjet në ato dispozita të ligjit ekzistues që kërkojnë përmirësim, pa ndryshuar në mënyrë të plotë strukturën e tij.

Gjithashtu, ai konsiderohet më efikas në raport me opsionet e tjera, pasi mundëson arritjen e harmonizimit me kuadrin e Bashkimit Evropian me kosto më të ulëta institucionale dhe në një afat kohor më të shkurtër. Në krahasim me hartimin e një ligji të ri, ky opsion shmang kostot e larta administrative dhe vonesat procedurale që do të ndikonin në procesin e integritimit evropian.

Në të njëjtën kohë, Opsioni 2 është më i zbatueshëm në praktikë, pasi bazohet në një kuadër ligjor ekzistues që tashmë është funksional dhe i njohur nga subjektet e tregut, duke lehtësuar procesin e përshtatjes dhe duke reduktuar rrezikun e ndërprerjeve në funksionimin e tregut të shërbimeve të pagesave.

**Opsioni 3 (rregullator):** – Miratimi i një ligji të ri në fushën e shërbimeve të pagesave. Hartimi i një ligji të ri do të bëhej mbi bazën e konsoliduar të PSD2, EMD2 dhe ndryshimeve të tyre, duke shmangur çdo mbivendosje apo paqartësi që vjen nga ndryshimet e ligjit ekzistues. Miratimi i një ligji të ri do të lejonte riorganizimin e plotë të kapitujve dhe dispozitave, duke bashkuar në një instrument të vetëm rregullimin e shërbimeve të pagesave dhe të institucioneve të parasë elektronike, pa nevojën e shtimit të neneve të ndërmjetëm në ligjin ekzistues. Miratimi i një akti të ri ligjor gjithëpërfshirës do të jepte edhe një mesazh të qartë ndaj institucioneve të BE-së lidhur me vullnetin e Shqipërisë për harmonizim të plotë dhe të qëndrueshëm.

Ky opsion nuk është i përshtatshëm, për arsye se ndryshimet që synohen të ndërmerren për zgjidhjen e mangësive të evidentuara, nuk ndikojnë në thelbin e ligjit ekzistues dhe për më tepër hartimi i një ligji të ri paraqet kosto më të madhe në drejtim të burimeve materiale dhe njerëzore krahasuar me opsionet e tjera. Nëpërmjet ndryshimeve të ligjit ekzistues synohet të rregullojnë dispozitat e munguara të cilat lidhen me marrëdhëniet ndërkufitare dhe vendosjen e rregullave të detajuara për aktivitetin ndërkufitar ose me aktivitetin e institucioneve të parasë elektronike, të cilat nuk ndikojnë në thelbin dhe strukturën e ligjit ekzistues. Për më tepër hartimi i një ligji të ri paraqet kosto më të madhe në drejtim të burimeve materiale dhe njerëzore krahasuar me opsionet e tjera. Hartimi i një ligji të ri kërkon edhe afate të gjata konsultimi publik dhe ndërinstitutional, si dhe shqyrtim të

zgjerruar, gjë që do të vononte implementimin e tij dhe mund të ndikonte në mosrespektimin e afateve të harmonizimit me *acquis* të BE-së dhe piketat mbyllëse të Kapitullit 4.

## **Përzgjedhja e opsioneve të shqyrtuara**

Opsionet e mësipërme janë përzgjedhur duke marrë në konsideratë nevojën për të adresuar problematikat e identifikuara në kuadrin aktual ligjor, kërkesat që rrjedhin nga procesi i integritimit evropian dhe zhvillimet e fundit në legjislacionin e Bashkimit Evropian në fushën e shërbimeve të pagesave, si dhe nevoja e rregullimit në formë ligjore të aktivitetit të institucioneve të parasë elektronike.

Pas analizimit të përfitimeve dhe kostove të secilit opsion, është vlerësuar se opsioni i ndryshimit të ligjit ekzistues përmes shtesave dhe ndryshimeve të targetuara (Opsioni 2) përfaqëson alternativën më të përshtatshme dhe më efektive për arritjen e objektivave të synuar. Ky opsion mundëson një përafrim të mëtejshëm me legjislacionin e Bashkimit Evropian, duke ruajtur stabilitetin e kuadrit ligjor ekzistues dhe duke minimizuar kostot administrative dhe institucionale.

## **Arsyetimi i opsionit të preferuar**

- *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
- *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Opsioni i zgjedhur 2, është vlerësuar më i favorshëm për arsyet e mëposhtme:

### **1. Proporcionaliteti i ndërhyrjes ligjore në raport me natyrën e problemit**

Opsioni 2 është i preferuar, para së gjithash, sepse respekton parimin e proporcionalitetit të ndërhyrjes rregullatore. Problematikat e identifikuara nuk rrjedhin nga mangësi strukturore të ligjit nr. 55/2020 në tërësinë e tij, por janë të krijuara si pasojë e zhvillimeve të legjislacionit evropian pas miratimit të ligjit dhe e nevojës për të adresuar çështje që nuk kanë qenë relevante në kohën e hartimit të tij. Në këto kushte, ndryshimi i ligjit ekzistues mundëson ndërhyrjen pikërisht në çështjet ku nevojitet, duke ruajtur të paprekura dispozitat që funksionojnë mirë dhe janë zbatuar me sukses gjatë zbatimit të tij.

### **2. Respektimi i afateve të procesit të integritimit në BE**

Opsioni 2 është një opsion që siguron harmonizimin e plotë me *acquis* të BE-së brenda afateve të shkurtra kohore të kërkuara nga procesi i negociatave dhe plotësimi i piketave mbyllëse të Kapitullit 4. Ndryshimi i ligjit ekzistues mund të miratohet dhe të hyjë në fuqi brenda një afati më të shkurtër se miratimi i një ligji të ri.

### **3. Efikasiteti i burimeve institucionale dhe administrative**

Opsioni 2 optimizon përdorimin e burimeve njerëzore dhe institucionale. Ndryshimi i ligjit ekzistues mundëson që ky kapital institucional të ruhet dhe të shfrytëzohet, duke shtuar vetëm ato dispozita që mungojnë. Duke marrë parasysh që Opsioni 2 nuk paraqet kosto buxhetore për shtetin, ai mbetet alternativë efektive nga pikëpamja e shpenzimeve publike.

#### **4. Qëndrueshmëria e kuadrit rregullator dhe siguria juridike për subjektet e tregut**

Ligji nr. 55/2020 është zbatuar që nga koha e hyrjes së tij në fuqi, duke krijuar një praktikë institucionale dhe rregullatore të konsoliduar. Subjektet e ligjit kanë përshtatur procedurat, kontratat, sistemet teknologjike dhe strukturat organizative me kërkesat e këtij ligji. Ndryshimi i tij nëpërmjet Opsionit 2 siguron vazhdimësi, duke mos sjellë ndryshime thelbësore për subjektet e ligjit.

#### **5. Mundësia e integritit të plotë të kërkesave të EMD2 pa nevojën e instrumentit të ri**

Një nga argumentet kryesore në favor të Opsionit 3 ishte se ligji i ri do të mundësonte bashkimin në një instrument të vetëm të rregullimit të shërbimeve të pagesave dhe të parasë elektronike. Megjithatë, Opsioni 2 arrin të njëjtin rezultat nëpërmjet shtimit të kapitujve specifikë për institucionet e parasë elektronike në ligjin ekzistues, pa pasur nevojë për ligj të ri. Zgjedhja e Opsionit 2 ndjek këtë praktikë të shumë shteteve anëtare të BE-së, të cilat kanë integruar EMD2 në aktet e tyre ekzistuese mbi PSD2, pa miratuar instrumente të reja ligjore.

Në përfundim, Opsioni 2 është opsioni i preferuar sepse kombinon në mënyrën më të ekuilibruar të gjitha kriteret e vlerësimit: arrin harmonizimin e plotë me *acquis* të BE-së, respekton afatet e procesit të anëtarësimit, minimizon kostot dhe rreziqet për tregun dhe buxhetin e shtetit, ruan qëndrueshmërinë e kuadrit rregullator dhe ka mbështetje institucionale dhe ligjore të plotë. Opsioni 2 përmbush edhe nevojën e rregullimit me ligj të kërkesave kryesore për institucionet e parasë elektronike, për të siguruar një trajtim të unifikuar edhe me institucionet e pagesave të cilat gjithashtu rregullohen kryesisht me ligj.

Efektet financiare opsionit të preferuar janë të pamundura të vlerësohen pasi gjithçka varet nga pozicionimi strategjik i institucioneve për të përfituar nga avantazhet konkurruese që mund t'i ofrojnë ndryshimet ligjore, si dhe nga përdorimi i infrastrukturave dhe sistemeve të pagesave. Vlerësimi i volumeve të pritshme dhe efekteve në kosto për 10 vitet e ardhshme, nuk është i mundur të vlerësohet dhe parashikohet me informacionin aktual.

**Për vlerësimin e opsionit të preferuar, janë identifikuar pesë kritere kryesore, për të vlerësuar efektivitetin, përputhshmërinë dhe qëndrueshmërinë e ndërhyrjes ligjore. Këto kritere janë vlerësuar me pikë për secilin opsion si vijon:**

1. Harmonizimi i plotë me *acquis* të BE-së (PSD2 dhe ndryshimet e saj, EMD2) - Pesha 5
2. Qëndrueshmëria e kuadrit rregullator dhe siguria juridike për subjektet e tregut — Pesha 4
3. Krijimi i mekanizmave për veprimtarinë ndërkufitare dhe “*passporting*” — Pesha 4
4. Efikasiteti i forcimit të mbrojtjes së konsumatorëve dhe transparencës në kostot e pagesave — Pesha 3
5. Kosto-efektiviteti — Pesha 5

Sistemi i pikëzimit: 0 = nuk e arrin objektivi / 1 = e arrin pjesërisht / 2 = e arrin plotësisht

| Kriteret  | Pesha | Opsioni 0 | Opsioni 1 | Opsioni 2 | Opsioni 3 |
|---|-------|-----------|-----------|-----------|-----------|
| Harmonizimi i plotë me <i>acquis</i> të BE-së (PSD2 dhe ndryshimet e saj, EMD2)             | 4     | 0 (0)     | 0 (0)     | 4(16)     | 4(16)     |
| Qëndrueshmëria e kuadrit rregullator dhe siguria juridike për subjektet e tregut            | 4     | 1 (4)     | 1 (4)     | 4(16)     | 3(12)     |
| Krijimi i mekanizmave për veprimtarinë ndërkufitare dhe mekanizmin e “ <i>passporting</i> ” | 4     | 0 (0)     | 0 (0)     | 4(16)     | 4(16)     |
| Efikasiteti i forcimit të mbrojtjes së konsumatorëve dhe transparencës në kostot e pagesave | 3     | 1 (3)     | 2 (6)     | 3(9)      | 3(9)      |
| Kosto-efektiviteti  | 5     | 1 (5)     | 2 (10)    | 5(25)     | 4(20)     |
| <b>Pikët</b>  |       | <b>12</b> | <b>20</b> | <b>82</b> | <b>73</b> |

Bazuar në vlerësimin e secilit opsion në raport me kriteret e përcaktuara, rezulton se opsioni 3 ka numrin më të lartë të pikëve (82 pikë), duke u vlerësuar si opsioni më i përshtatshëm.

### Çështje të zbatimit

- *Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*

Banka e Shqipërisë do të jetë struktura që do të ndjekë zbatimin e ndryshimeve të ligjit në drejtim të:

- licencimit dhe të mbikëqyrjes së institucioneve të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike, dhe të gjithë subjekteve të tjera të këtij ligji,
- ndjekjes së zbatimit të kërkesave ligjore për lejjimin e ofruesve të shërbimeve të pagesave për të operuar një sistem pagesash ose për të marrë pjesë në sistemet e pagesave, sipas kërkesave të rishikuara;
- hartimit të akteve nënligjore në zbatim të kërkesave të reja apo të rishikuara të ligjit;
- njësisë ZAM, për shqyrtimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshje jo në rrugë gjyqësore, ndërmjet konsumatorëve ose mikrondërmarrjeve dhe ofruesve të shërbimeve të pagesave

apo emetuesve të parasë elektronike, për shkelje të pretenduara të këtij ligji nga ana e ofruesve të shërbimeve të pagesave apo emetuesve të parasë elektronike;

- bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit me autoritetet homologe të shteteve anëtare të BE-së, kur Shqipëria të bëhet shtet anëtar dhe subjektet të përdorin të drejtën e “*passporting*”.
- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*

Zbatimi i ndryshimeve të propozuara mund të përballet me disa pengesa praktike dhe institucionale, të cilat lidhen kryesisht me kapacitetet institucionale, përshtatjen e subjekteve me kërkesat e reja dhe kostot e zbatimit të tyre.

Së pari, një nga pengesat kryesore lidhet me kapacitetet profesionale dhe teknike jo vetëm të subjekteve, por edhe përshtatja e vazhdueshme e kapaciteteve institucionale të Bankës së Shqipërisë për zbatimin e këtij ligji.

Gjithashtu, ekziston mundësia që disa nga subjektet e prekura, veçanërisht subjektet e vogla, të përballen me kosto të cilat për madhësinë e tyre të jenë të konsiderueshme.

Megjithatë, këto pengesa konsiderohen të menaxhueshme dhe mund të adresohen përmes trajnimeve profesionale, takimeve me subjektet dhe orientimin e tyre për t’u përshtatur me kërkesat e reja, me kosto sa më të ulëta.

- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*
- *Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.*

Për të siguruar zbatimin efektiv të ndryshimeve të propozuara në ligjin 55/2020 “Për shërbimet e pagesave”, do të ndërmerren një sërë masash institucionale, rregullatore dhe administrative, të cilat edhe harmonizimin e mëtejshëm me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Së pari, do të realizohet përditësimi dhe plotësimi i kuadrit nënligjor që lidhet me zbatimin e ligjit për shërbimet e pagesave, duke reflektuar ndryshimet që vijnë nga ndryshimi i ligjit në fjalë. Në këtë kuadër, pas miratimit të ndryshimeve ligjore, parashikohet të bëhen edhe disa ndryshime në aktet nënligjore ekzistuese, të miratuara në zbatim të ligjit në fuqi, me qëllim përshtatjen e atyre dispozitave që lidhen me ndryshimet ligjore.

Akte të mundshme ku parashikohet të hartohen ndryshime janë:

1. Rregullorja 59/2021 "Për licencimin e institucioneve të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike, si dhe për regjistrimin e ofruesve të shërbimeve të pagesave"
2. Rregullorja 7/2022 "Për regjistrin publik të ofruesve të shërbimeve të pagesave"
3. Rregullorja 29/2022 "Për autentifikimin e thelluar të klientit dhe standardet e përbashkëta, të hapura dhe të sigurta të komunikimit"
4. Rregullorja 14/2023 "Për ushtrimin e veprimtarisë dhe mbikëqyrjen e institucioneve të pagesave"
5. Rregullorja 57/2022 "Për ushtrimin e veprimtarisë dhe mbikëqyrjen e institucioneve të parasë elektronike".

Gjithashtu, në zbatim të parashikimit ligjor Banka e Shqipërisë do të përcaktojë me akt nënligjor, kërkesat për tarifatat e shkëmbimit dhe kërkesat teknike dhe të biznesit për transaksionet e pagesave të bazuara në kartë.

Së dyti, do të ndërmerren masa për forcimin e kapaciteteve profesionale dhe institucionale të punonjësve të Bankës së Shqipërisë, që do të ndjekin zbatimin e kërkesave të reja dhe të rishikuara ligjore. Kjo do të realizohet përmes programeve të trajnimit, veçanërisht me bankat qendrore europiane, për të përfituar edhe nga praktika e tyre për zbatimin e kërkesave të Direktivave përkatëse. Aktualisht nuk mund të parashikohen kostot për trajnimin e stafit, por Banka e Shqipërisë do t'i konsiderojë nevojat për trajnim dhe do t'i përfshijë në buxhetin e saj për vitet e ardhshme. Gjithashtu, zhvillimi i kapaciteteve do të realizohet edhe në kuadër të projekteve me Banka Qendrore të shteteve të BE-së, por edhe me ekspertizën e institucioneve të tjera ndërkombëtare.

- *Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.*

Zbatimi i projektligjit kërkon përmbushjen e një sërë kërkesash nga subjektet e tij.

Për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat e reja dhe të rishikuara, Banka e Shqipërisë do të kryejnë monitorimin dhe mbikëqyrje të vazhdueshme, duke ndërmarrë edhe masa administrative apo sanksione sipas parashikimeve të reja ligjore, në rastet e mosrespektimit të këtyre kërkesave ligjore.

### **Faza e shqyrtimit/vlerësimit**

- *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*

Banka e Shqipërisë, në funksion të përmbushjes së objektivave të saj strategjike, do të monitorojë në vazhdimësi zbatimin e opsionit të përzgjedhur, kryesisht në drejtim të:

- Analizave periodike nga jashtë (*offsite*) dhe mbikëqyrjes në vend (*onsite*) të subjekteve të licencuara prej saj, në drejtim të zbatimit të kërkesave të reja ligjore;
- Monitorimit të zhvillimeve infrastrukturore nga ana e subjekteve, me qëllim ofrimin e shërbimeve të sigurta dhe me standarde, si dhe pjesëmarrjen e këtyre të fundit në sistemet e pagesave;
- Vlerësimit të shkallës së përdorimit të pagesave elektronike bazuar edhe në raportimet e subjekteve, dhe si rrjedhojë, reduktimit të përdorimit të parasë fizike (*cash*) në ekonominë shqiptare;
- Ndjekjes në vazhdimësi të numrit të ankesave të paraqitura për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve midis konsumatorëve / mikrondërmarrjeve dhe ofruesve të shërbimeve të pagesave apo emetuesve të parasë elektronike, si dhe të zgjidhjeve të dhëna prej tyre.

- *Identifikoni kriteret/ treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre*

Së pari, një tregues i rëndësishëm do të jetë **niveli i përafrimit të legjislacionit dhe kuadrit nënligjor me standardet e Bashkimit Evropian**, duke përfshirë adoptimin e plotë të dispozitave që lidhen me “*passporting*”, qëndrueshmërinë operationale digjitale dhe pagesat e menjëhershme. Ky vlerësim do të bazohet në analizat e progresit në kuadër të procesit të integritimit evropian dhe raportimet përkatëse institucionale.

Së dyti, do të monitorohet **rritja e numrit të institucioneve të licencuara dhe pjesëmarrjes së tyre në treg**, përfshirë institucionet e pagesave dhe të parasë elektronike, si dhe zgjerimi i aktivitetit të tyre, përfshirë edhe në dimensionin ndërkufitar. Kjo do të shoqërohet me tregues mbi zhvillimin e konkurrencës dhe diversifikimin e shërbimeve të ofruara.

Një tregues tjetër kyç lidhet me **rritjen e përdorimit të pagesave elektronike dhe reduktimin e përdorimit të cash-it**, në përputhje me objektivat e nismës “Cashless Albania 2030”. Ky tregues do të matet përmes volumit dhe vlerës së transaksioneve elektronike, dhe aksesit të qytetarëve dhe bizneseve në këto shërbime.

Gjithashtu, do të vlerësohet **niveli i sigurisë dhe qëndrueshmërisë operationale të sistemeve të pagesave**, duke përfshirë numrin dhe natyrën e incidenteve të sigurisë, efektivitetin e mekanizmave të raportimit dhe reagimit, si dhe përputhshmërinë me kërkesat për menaxhimin e rrezikut dhe mbrojtjen e të dhënave.

Një tjetër tregues i rëndësishëm është **përmirësimi i mbrojtjes së përdoruesve dhe rritja e transparencës në treg**, i cili do të matet përmes reduktimit të ankesave nga përdoruesit, rritjes së nivelit të informimit dhe besimit në shërbimet e pagesave, si dhe përmirësimin të kushteve të ofruara nga operatorët.

Në fund, do të vlerësohet edhe **efektiviteti i mbikëqyrjes dhe i koordinimit institucional**, përmes treguesve si koha e përpunimit të aplikimeve për licencim, cilësia e procesit mbikëqyrës dhe niveli i bashkëpunimit me autoritetet homologe ndërkombëtare, në veçanti në kontekstin e operationeve ndërkufitare.

## **Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca2/a**

*Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.*

|   | Viti 1 | Viti 2 | Viti 3 | Viti 4 | Viti 5 | Viti 6 | Viti 7 | Viti 8 | Viti 9 | Viti 10 |
|---|--------|--------|--------|--------|--------|--------|--------|--------|--------|---------|
| <b>Faktori zbritës</b>  |        |        |        |        |        |        |        |        |        |         |
| Kosto për buxhetin – njëherë  |        |        |        |        |        |        |        |        |        |         |
| Kosto për buxhetin – në vazhdim   |        |        |        |        |        |        |        |        |        |         |
| Kosto për biznesin – njëherë  |        |        |        |        |        |        |        |        |        |         |
| Kosto për biznesin – në vazhdim   |        |        |        |        |        |        |        |        |        |         |
| Kosto për grupet e tjera – njëherë  |        |        |        |        |        |        |        |        |        |         |
| Kosto për grupet e tjera – në vazhdim   |        |        |        |        |        |        |        |        |        |         |
| <b>Kosto në total</b>   |        |        |        |        |        |        |        |        |        |         |
| <b>Kosto e zbritur në total</b><br>= Kosto në total x faktorin zbritës                                  |        |        |        |        |        |        |        |        |        |         |
| Përfitimi për buxhetin – në vazhdim   |        |        |        |        |        |        |        |        |        |         |
| Përfitimi për biznesin – njëherë  |        |        |        |        |        |        |        |        |        |         |
| Përfitimi për biznesin – në vazhdim (ndryshimi I primit)  |        |        |        |        |        |        |        |        |        |         |
| Përfitimi për grupet e tjera – njëherë  |        |        |        |        |        |        |        |        |        |         |
| Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim   |        |        |        |        |        |        |        |        |        |         |
| Kosto për buxhetin – në vazhdim   |        |        |        |        |        |        |        |        |        |         |
| <b>Përfitimi në total</b>   |        |        |        |        |        |        |        |        |        |         |
| <b>Përfitimi i zbritur në total</b> = Përfitimi në total x faktorin zbritës                             |        |        |        |        |        |        |        |        |        |         |
| <b>Vlera aktuale e kostos në total</b>  |        |        |        |        |        |        |        |        |        |         |
| <b>Vlera aktuale e përfitimit në total</b>  |        |        |        |        |        |        |        |        |        |         |
| <b>Vlera aktuale neto (VAN)</b> = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total |        |        |        |        |        |        |        |        |        |         |

## Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

| Opsioni   | Vlera aktuale në milionë lekë |           | Vlera aktuale neto në milionë lekë |
|-----------|-------------------------------|-----------|------------------------------------|
|           | Kosto                         | Përfitimi |                                    |
| Opsioni 1 |                               |           |                                    |
| Opsioni 2 |                               |           |                                    |

**MINISTRI I FINANCAVE**

**PETRIT MALAJ**